



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË**

---

K.DH.Shk.II. nr.712/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, Gjyqtari Dren Rogova, në çështjen përmbareme të kreditorit “Dardafon.Net” L.L.C., me numër unik identifikues 810745416, me seli në fshatin Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.M. avokat nga Prishtina, si dhe L.S jurist, kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me numër unik identifikues 811288001 me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë D.A, L.S, dhe F.K, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/2023 të datës 16.02.2024 dhe KPPP.nr.2074/2023 të datës 15.03.2024, pas mbajtjes së seancave dëgjimore të datës 12.04.2024, 02.05.2024, 15.05.2024 dhe 28.05.2024, me datë 07.06.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar ankesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, ashtu që **NDRYSHOHET** pika I. e dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/2023 të datës 16.02.2024, dhe gjykohet si në vijim:
1. **SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbareusi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 282,931.51 € (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë e një cent).
  2. **MBETET NË FUQI** Urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbareusi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,449,939.83€ (pesë milion e katërqind e katër dhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e tre cent)
- II. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** ankesa e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A për pikat “II”, “III” dhe “IV” të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/2023 të datës 16.02.2024, ashtu që i njëjti në këto pika të dispozitivit **VËRTETOHET**.
- III. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** ankesa e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A e datës 19.03.2024 dhe **VËRTETOHET** Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 i datës 15.03.2024.

## A r s y e t i m

### I. Çështja gjyqësore

1. Me aktvendimin KPPP.nr. 2074/23 të datës 16.02.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në pikën I të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., dhe është lënë në fuqi Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34 € (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent). Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar Ankesa për parregullsi e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., e datës 14.11.2022, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm urdhri i përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha P.nr.491/19, i datës 01.11.2022 për kryerjen e pagesës në mënyrë vullnetare në shumën totale prej 6,066,427.51 €, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore. Në pikën III të dispozitivit të aktvendimit është hedhur poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., e datës 14.01.2022 me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të pezullohet procedura përmbarimore P.nr 491/19 e datës 15.07.2019. ndërkaq me pikën IV është hedhur poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet kreditori “DARDAFON.NET” L.L.C., që deri në përfundimin e procedurës gjyqësore përmbarimore, të deponojë në llogarinë e gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv në vlerën prej 13,116,165.73 €.

2. Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, me datë 22.02.2024 debitori Telekom i Kosovës ka ushtruar ankesë në Dhomat e Shkallës së Dytë kundër aktvendimit KPPP.Nr.2074/2023 të datës 16.02.2024 dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me ankesë debitori ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit Telekom i Kosovës të ndryshohet aktvendimi aktvendimin KPPP.nr. 2074/23 të datës 16.02.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ashtu që: (III.) Aprovohet në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit i dt.18.07.2019 dhe plotësimi i prapësimit me parashtrësën e dt.10.10.2022, ndryshohet pika I. e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP2074/23 i dt.16.02.2024 ashtu që të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.491/19 i datës 15.07.2019 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34.

3. Me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 27.02.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e ushtruar nga Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, për përjashtimin e Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu nga procedimi në çështjen përmbarimore P.nr.977/23 të datës 15.12.2023.

4. Me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024, të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është refuzuar si e pabazuar Ankesa për parregullsi e Debitorit “TELEKOMI I KOSOVËS”, Sh.A., e datës 08.03.2024, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet

përmbaruesi privat Irfan I. Kërçagu që sipas Aktvendimit KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024 të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, të vazhdoj përmbarimin sipas marrëveshjes Nr.01-156/09 të datës 17.11.2020, për pagesën e borxhit me këste mujore; të detyrohet përmbaruesi privat që të bëj njoftimin e menjëhershëm të të gjitha Bankave Komerciale në Republikën e Kosovës që pas realizimit të tërheqjes së mjeteve nga kësti i 15-të, të liroj menjëherë llogaritë bankare dhe bllokimi i radhës eventual të realizohet nga data 15 deri me datën 20 të secilit muaj pasues sipas kushteve nga Marrëveshja nr.01-156/09, e datës 17.11.2020 deri në një vendosje ndryshe nga ndonjë vendim gjyqësor; të detyrohet përmbaruesi privat që të përmirësoj urdhrin përmbarimor ashtu që të precizoj shumën e përmbarimit sipas Aktvendimit KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024, në vlerën prej 5,732,871.34 € / 10 këste dhe ta përpjesëtoj të njëjtën me 10 këste për secilin këst mujor; të detyrohet përmbaruesi privat që për të gjitha shpenzimet e efikasitetit për secilin këst të veçantë, ti përcjellë me faturë të veçantë pas secilit inkasim veç e veç si dhe të obligohet përmbaruesi që në rast të tërheqjes më të lartë se të një kësti mujor deri në vendosjen sipas kësaj parashtrëse, çdo diferencë e shumës së tillë ta zbatoj e llogaritë si pagesë të këstit pasues të radhës.

5. Kundër këtij aktvendimi me datë 20.03.2024 debitori Telekom i Kosovës ka parashtruar ankesë në Dhomat e Shkallës së Dytë, me të cilën ka propozuar që të aprovohet ankesa e Telekomit të Kosovës dhe të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024, i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, sipas dispozitivit të propozuar nga debitori.

6. Objekt shqyrtimi në Dhomat e Shkallës së Dytë janë ankesat e debitorit Telekom i Kosovës:

- a) Ankesa e datës 22.02.2024 e debitorit Telekom i Kosovës ndaj aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale KPPP.Nr.2074/2023 të datës 16.02.2024, për urdhrin për përmbarim të lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha P.nr.491/19 të datës 15.07.2019.
- b) Ankesa e datës 20.03.2024 e debitorit Telekom i Kosovës e parashtruar kundër aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024, lidhur me parregullsitë e përmbarimit

## *II. Historiku procedural i çështjes përmbarimore*

7. Kreditori Dardafon.net LLC, me datë 08.07.2019 ka parashtruar propozim për përmbarim tek përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha, për përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor - Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit OEN Nr.20990 / MHM, të datës 9 dhjetor 2016.

8. Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "DARDAFON NET" L.L.C, në bazë të dokumentit përmbarimor – Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit OEN Nr.20990 / MHM, të datës 9 dhjetor 2016, i njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike sipas Aktvendimit me numër IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019 ka nxjerrë urdhrin përmbarimor

P.nr.491/19 të datës 15.07.2019, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj debitorit “TELEKOMI I KOSOVËS”, sh.a., dhe ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Urdhri në pikën II që: a) kreditorit t’ia paguaj shumën prej 8,785,000.00 €, në emër të shpërblimit të dëmit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 14.04.2015, e deri në pagesën përfundimtare; b) në emër të fitimit të humbur shumën prej 17,315,000.00 €, së bashku me kamatën prej 8 % në vit, nga data 14.04.2015, e deri në pagesën përfundimtare; c) në emër të vonesës për ofrimin e numrave mobil nga pika II (a) dhe ofrimin e shërbimeve 3/4G nga pika II (b), shumën prej 5,000.00 € në ditë, nga data 09.12.2016 e deri më datën 24.05.2017, së bashku me kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 14.04.2015, e deri në pagesën përfundimtare; d) shumën prej 972,121.22 € dhe shumën prej 534,000.00 USD, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 09.12.2016 e deri në pagesën përfundimtare; e) nga pikat më lartë të zbritet shuma prej 10,156,491.23€ e paguar nga debitori; në pikën III ka obliguar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,150.00 € në emër të shpenzimeve të përfaqësimit në Procedurën e Njohjes dhe Ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit, si dhe shpenzimet e përfaqësimit në procedurën përbarimore sipas TOAK-së, të datës 18.03.2017, nga fillimi i procedurës përbarimore e deri në përfundimin e saj; në pikën IV ka detyruar debitorin që: ti bartë shpenzimet e procedurës përbarimore sipas pasqyrës së përbaruesit privat në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2014 për tarifën, shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve të përbaruesve privat dhe në pikën V dhe VI ka obliguar debitorin që në rast të mos përmbushjes së detyrimit, të caktohet përbarimi i dhunshëm dhe detyrimet e debitorit të realizohen përmes zbatimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të përbaruesit privat si dhe nëse me rastin e përbarimit të dhunshëm nuk ka mjete në llogaritë bankare të debitorit, përbarimi të shtrihet në pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

9. Kundër urdhrin për përbarim, debitori Telekom i Kosovës kishte paraqitur prapësim me datën 18.07.2019, me të cilën kishte kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor të lejuar, me pretendimin që dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përbarimor, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe se palët janë pajtuar që të mos kërkohet përbarimi në bazë të dokumentit përbarues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë. Debitori ka theksuar që nuk është e qartë se në bazë të cilit dokument kërkohet përbarimi, përkatësisht nëse kërkohet përbarimi i Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Paris nr.20990/MH të datës 09.12.2016, apo Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike sipas numrit IV. C.nr. 388/18 të datës 11.02.2018, duke deklaruar që urdhri është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak se asnjëri nga këto vendime nuk përmbajnë klauzolën e përbarueshmërisë.

10. Sipas prapësimit të debitorit kërkesa për përbarim është e papërshtatshme meqenëse nuk është treguar dhe nuk përmban shumën/vlerën e saktë të kërkesës së kreditorit siç përcaktohet me dispozitat e nenit 27.1 të LPP-së. Po ashtu ka deklaruar që në rastin konkret palët janë marr vesh që të mos kërkohet përbarimi në bazë të dokumentit përbarimor dhe për këtë edhe është lidhur Marrëveshja në mes të palëve në procedurë për ekzekutimin e vendimit final të Arbitrazhit OEN 20990/MHM datë 9.12.2016 (Marrëveshje për Ekzekutim) e datës

24.05.2017, përmbajtjen e së cilës palët e kanë vërtetuar pranë Noterit Sefadin Blakaj me aktin “Vërtetim i dokumentit privat” LRP.6316/2019 dhe Ref. 1202/2017, përmes të cilës kreditori është pajtuar që të mos kërkoj përmbartimin e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, ku në bazë të së cilës marrëveshje kreditori kishte tërhequr propozimin për njohjen dhe ekzekutimin e Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit OEN 20990/MHM datë 9.12.2016, me ç’rast edhe Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike sipas Aktvendimit IV.Ek.nr 118/17 të datës 19.06.2017 ka konstatuar se kreditori ka tërhequr propozimin e datës 07.03.2017 kundër debitorit. Debitori ka pretenduar se meqenëse kreditori e ka shkëputur Marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit final të Arbitrazhit, ndërsa debitori nuk e kishte kundërshtuar shkëputjen, mirëpo e ka kundërshtuar vetëm vlefshmërinë dhe pasojat juridike të kësaj shkëputje vetëm ndaj pikës 8.1 (i) të saj, duke theksuar se klauzola/marrëveshja e arbitrazhit sipas të cilit është zhvilluar procesi dhe është nxjerrë Vendimi përfundimtar, trajtohet si klauzolë/marrëveshje e veçantë dhe e pavarur ndaj raportit kontraktues ndërmjet palëve, pavarësisht faktit se e njëjta mund të jetë pjesë integrale e kontratës komerciale ndërmjet palëve dhe se ky qëndrim dhe interpretim i njohur nga praktika e tribunaleve më respektabile ndërkombëtare bazohet në “Doktrinën Separate.” I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor dhe të refuzohet si i pabazuar propozimi për përmbartim i kreditorit ndërsa shpenzimet e procedurës së përmbartimit të bien në barrë të kreditorit.

11. Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar që propozimi për përmbartim është iniciuar në bazë të dokumentit me titull ekzekutiv - Vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit 20990/MHM datë 09.12.2016, i shpallur si i ekzekutueshëm me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019, i cili vendim përbën titull ekzekutiv sipas nenit 24 par. 1 të LPP-së.

12. Në përgjigje në prapësim, kreditori pretendon se petitumi i vendimit të Arbitrazhit nuk është i diskutueshëm por vetëm i zbatueshëm në suaza të vlerësimit dhe ekzekutimit të titullit përmbartimor që cilësohet të ketë i njëjti dhe se i njëjti vendim i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 27 të LPP-së. Ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit për lartësinë e borxhit, ka theksuar që kreditori në propozimin për përmbartim ia ka njohur debitorit pagesat e kryera të cilat arrijnë lartësinë e shumës 10,156,491.23 €, për të cilën shumë nuk ka kërkuar përmbartimin, duke shtuar që debitori asnjëherë nuk e ka precizuar shumën përkatëse të paguar ndaj kreditorit dhe nuk e ka saktësuar lartësinë e pagesave të kryera nga detyrimi i tij. Lidhur me pretendimin e debitorit rreth ekzekutimit të Marrëveshjes për zbatimin e Vendimit të Arbitrazhit dhe shkëputjes së saj apo heqjes dorë nga përmbartimi i Vendimit të Arbitrazhit, ka theksuar që e njëjta është dashur të potencohet në procedurën e njohjes dhe shpalljes së ekzekutueshme të Vendimit të Arbitrazhit dhe jo në procedurë përmbartimore. Ndërsa lidhur me pretendimin për vëllimin dhe shtrirjen e përmbartimit, kreditori ka theksuar se në rast se në llogaritë bankare të debitorit nuk ka mjete të mjaftueshme për realizim të përmbartimit, atëherë qartë përcaktohet se përmbartimi do të ekzekutohet përmes mjeteve financiare nga shitja e pasurisë së luajtshme dhe e paluajtshme e debitorit, konform dispozitave të Ligjit për procedurën përmbartimore.

13. Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me këtë çështje përmbartimore ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 22.06.2020, në të cilën seancë përmes konkluzionit është detyruar kreditori që në afat prej 3 ditësh të parashtrij në gjykatë parashtrësën për precizimin e propozimit për përmbartim lidhur me shumën e përgjithshme të borxhit kryesor si dhe për pikat “c, d, e” të propozimit të kreditorit, nën kërcënim të pasojave ligjore.

14. Kreditori, përmes parashtrësës së datës 25.06.2020, ka bërë precizimin e propozimit për përmbartim në shumën e përgjithshme prej 24,684,003.15 €, duke ia shtuar kamatën ligjore prej 8% në vit nga data 08.07.2016 e deri në pagesën përfundimtare, përjashtimisht shumave në vlerën prej 1,660,000.00 €, të përbëra nga ndëshkimi kontraktues prej 5,000.00 € në ditë për periudhën nga data 09.12.2016 - 24.05.2017 dhe shumën prej 1,477,851.22 €, në emër të shpenzimeve të përfaqësimit në procedurën e arbitrazhit, përkatësisht nga borxhi i përgjithshëm sipas vendimit të arbitrazhit deri me datën 08.07.2016, prej shumës në vlerën prej 35,155,308.81 €, ka kërkuar shumën prej 24,684,003.15 €.

15. Debitori përmes parashtrësës së datës 07.07.2020, është deklaruar sa i përket precizimit të propozimit për përmbartim të kreditorit, duke e kundërshtuar të njëjtën me arsyetimin se parashtrësja e kreditorit është paraqitur jashtë afatit të dhënë nga ana e Gjykatës, si dhe për shkakun se vlera e përcaktuar në precizimin e propozimit për përmbartim nuk është në përputhje me urdhrin përmbartimor të lejuar nga përmbartuesi privat, duke theksuar se gjykata ka bërë tejkalim të autorizimeve të saja ligjore dhe me nxjerrjen e konkluzionit të datës 22.06.2020 tërë procesin e ka rikthyer në fazën e procesit para përmbartuesit privat, duke theksuar se me precizimin e kërkuar është krijuar vlerë e re e përmbartimit, për të cilin nuk ekziston urdhri përmbartimor dhe se për të njëjtën nuk është ushtruar prapësimi.

16. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.1486/19 të datës 06.07.2020, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës SH.A., lidhur me shumën 315,996.85 €, dhe për këtë shumë e ka shfuqizuar Urdhrin për caktimin e përmbartimit P.nr. 491/2019 të datës 15.07.2019 të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës SH.A., lidhur me shumën prej 24,684,003.15 € dhe për këtë pjesë Urdhrin për Caktimin e Përmbartimit P.nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, të lëshuar nga përmbartuesi privat Ilir Mulhaxha e ka lënë në fuqi.

17. Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr. 3610/20 të datës 08.10.2020, e ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1486/2019 të datës 06.07.2020 e ka vërtetuar.

18. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit Telekom i Kosovës Sh.A., për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 3610/20 të 8 Tetorit 2020, me datën 8 shkurt 2021 ka marr Aktvendim për Papranueshmëri në rastin nr. KI 179/20.

19. Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit, përmes Aktvendimit CML.nr. 12/20 të datës 20.01.2021 e ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit.

20. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit Telekom i Kosovës Sh.A., për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20 të 20 Janarit 2021, me Aktgjykimin në rastin nr. KI 84/21 nr. ref AGJ 1918/21 të datës 17 dhjetor 2021, ka vendosur si në vijim: I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën e pranueshme, II. TË KONSTATOJË, me shumice votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës se Apelit Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020, IV. TË KTHEJË, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate, V. TË URDHËRJOË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri me datën 15 Mars 2022 për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës, VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër, VII. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme, VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit ta publikojë në Gazetën Zyrtare dhe IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

21. Pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për rastin KI 84/12 nr. ref AGJ 1918/21 të datës 17 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.265/22 të datës 07.02.2022 e ka aprovuar si të themeltë Ankesën e Debitorit Telekom i Kosovës. Sh.A., dhe e ka anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 1486/19 të datës 06.07.2020 dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm duke e marr numrin e ri të lëndës PPP.nr 161/22.

22. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, lënda në bazë të kompetencës lëndore është transferuar në Gjykatën Komerciale të Kosovës me datën 01.08.2022 dhe ka marrë numrin e ri të lëndës KPPP 1996/22.

23. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, në rivendosje me datën 10.10.2022, kishte mbajtur seancën dëgjimore lidhur me këtë çështje juridike dhe pas mbajtjes së shqyrtimit me Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 të datës 27.10.2022, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës SH.A., dhe ka Shfuqizuar pikën II (c) të dispozitivit të Urdhrit për Caktimin e Përmbarrimit P.nr.491/19 datë 15.07.2019 të lëshuar nga Përmbarruesi Privat Ilir Mulhaxha me seli të zyrës në Prishtinë, në shumën prej 1,660,000.00 €, së bashku me të gjitha kamatat që lidhen me këtë pikë të Urdhrit Përmbarrimor. Në pikën II të dispozitivit e ka Refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës sh.a, me NUI 81128800, me seli në Prishtinë në lidhje me pikat tjera të Urdhrit për Caktimin e Përmbarrimit P.nr.491/2019 të datës 15.07.2019 të lëshuar nga Përmbarruesi Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, dhe në pikën III të dispozitivit e ka Refuzuar si

të pa bazuar propozimin e debitorit Telekom i Kosovës sh.a. ,për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

24. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytës, me Aktvendimin Kom.Dh.shk.II.nr.1647/22 të datës 23.02.2023 në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e kreditorit Dardafon.Net L.L.C, me seli në fshatin Miradi – Komuna e Fushë Kosovës dhe e ka vërtetuar pikën I të dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1996/22 të datës 27.10.2022. Në pikën II të dispozitivit e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit “Telekomi i Kosovës”, sh.a me seli në Prishtinë dhe e ka prish aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë KPPP.nr. 1996/22 të datës 27.10.2020, në pikën II dhe III të dispozitivit dhe çështjen në këtë pjesë ia ka kthyer Gjykatës Komerciale – Dhomave të shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje duke marr numrin e ri të lëndës KPPP.nr.365/2023.

25. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje juridike, të kthyer për herë të dytë në rivendosje, ka mbajtur seancat dëgjimore me datat 04.04.2023 dhe 25.04.2023. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje përmbarimore të kthyer në rivendosje për herën e dytë me Aktvendimin KPPP.nr.365/2023 të datës 17.07.2023 (lidhja KPPP.nr 1996/22, PPP.nr 161/22). në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi të pabazuar Ankesën e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. të datës 14.11.2022 lidhur me parregullsitë e organit përmbarues Ilir Z. Mulhaxha me rastin e kryerjes së përmbarimit të Urdhrit P.nr.479/19 dt. 15.07.2019. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi propozimin e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullim të procedurës përmbarimore P.nr. 491/19 dt. 15.07.2019, sipas parashtresës së dt. 14.01.2022. Në pikën III të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi propozimin e Debitorit për caktimin e masës së sigurimit të datës 10.10.2022, të përsëritur me datën 4 dhe 25 prill 2022, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Kreditori Dardafon.net LLC që deri në përfundim të procedurës gjyqësore përmbarimore, të deponojë në llogari të gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuar përtej lartësisë së titullit ekzekutiv, në vlerë (të paktën) 13’116’165.73€ (trembëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e tre cent) apo në vlerën e cila do të precizohet sipas gjetjes nga ekspertiza e re gjyqësore financiare nga grupi i ekspertëve. Në pikën IV të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të dt. 18.07.2019 dhe plotësimin e prapësimit me parashtresën e datës 10.10.2022, dhe e ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor të Përmbaruesit Privat Ilir Z. Mulhaxha P.nr.491/19 dt. 15.07.2019 dhe në pikën V të dispozitivit e ka detyruar debitorin Telekom i Kosovës Sh.A. që në emër të borxhit të pa përmbushur sipas dokumentit përmbarimor me titull ekzekutiv / Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, t’ia paguaj Kreditorit Dardafon.net LLC shumën në lartësinë 5’732’871.34 € (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.



26. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytës, me Aktvendimin Kom.Dh.shk.II.nr.1128/23 të datës 30.11.2023 në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit “Telekomi i Kosovës”, sh.a me seli në Prishtinë dhe e ka prish aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë KPPP.nr. 365/23 të datës 17.07.2023 dhe çështjen ia ka kthyer Gjykatës Komerciale – Dhomave të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Në pikën II të dispozitivit janë urdhëruar Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, që procedurën e rishqyrtimit të çështjes ta zhvillojnë nga një gjyqtar tjetër i të njëjtës gjykatë.

27. Pas kthimit të lëndës në rivendosje nga Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, e njëjta ka marr numrin e ri KPPP.nr 2074/23, ndërsa me datën 29.12.2023, përmes konkluzionit të datës 15.12.2023, Gjykata është njoftuar se lënda përmbare P.nr.491/19 e Përmbareut Privat Ilir Mulhaxha është bartur tek Përmbareut Privat Irfan Kërçagu dhe e njëjta ka marr numrin e ri 977/23 dhe se të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbareut privat Ilir Mulhaxha janë valide dhe procedura do të vazhdohet aty ku ka mbetur.

28. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje përmbareut, të kthyer në rivendosje për herën e tretë, me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 vendos si në vijim:

I. REFUZHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Telekomi i Kosovës Sh.A., dhe MBETET NË FUQI, Urdhri për lejimin e përmbareut P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbareut Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34 € (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent).

II. REFUZHET NË TËRËSI si e pabazuar Ankesa për parregullsi e Debitorit Telekomi i Kosovës Sh.A., e datës 14.11.2022, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm urdhri i përmbareut privat Ilir Mulhaxha P.nr.491/19, i datës 01.11.2022 për kryerjen e pagesës në mënyrë vullnetare në shumën totale prej 6,066,427.51 €, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbareut.

III. Hedhet poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekomi i Kosovës Sh.A., e datës 14.01.2022 me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të pezullohet procedura përmbareut P.nr 491/19 e datës 15.07.2019.

IV. Hedhet poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekomi i Kosovës Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet kreditori “DARDAFON.NET” L.L.C., që deri në përfundimin e procedurës gjyqësore përmbareut, të deponojë në llogarinë e gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv në vlerën prej 13,116,165.73 €.

29. Me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024, të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është refuzuar si e pabazuar ankesa për parregullsi e Debitorit “TELEKOMI I KOSOVËS”, Sh.A., e datës 08.03.2024, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet përmbareut privat Irfan I. Kërçagu që sipas Aktvendimit KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024

të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, të vazhdoj përmbarimin sipas marrëveshjes Nr.01-156/09 të datës 17.11.2020, për pagesën e borxhit me këste mujore; të detyrohet përmbaruesi privat që të bëj njoftimin e menjëhershëm të të gjitha Bankave Komerciale në Republikën e Kosovës që pas realizimit të tërheqjes së mjeteve nga kësti i 15-të, të liroj menjëherë llogaritë bankare dhe bllokimi i radhës eventual të realizohet nga data 15 deri me datën 20 të secilit muaj pasues sipas kushteve nga Marrëveshja nr.01-156/09, e datës 17.11.2020 deri në një vendosje ndryshe nga ndonjë vendim gjyqësor; të detyrohet përmbaruesi privat që të përmirësoj urdhrin përmbarimor ashtu që të precizoj shumën e përmbarimit sipas Aktvendimit KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024, në vlerën prej 5,732,871.34 € / 10 këste dhe ta përpjesëtoj të njëjtën me 10 këste për secilin këst mujor; të detyrohet përmbaruesi privat që për të gjitha shpenzimet e efikasitetit për secilin këst të veçantë, ti përcjellë me faturë të veçantë pas secilit inkasim veç e veç si dhe të obligohet përmbaruesi që në rast të tërheqjes më të lartë se të një kësti mujor deri në vendosjen sipas kësaj parashtrëse, çdo diferencë e shumës së tillë ta zbatoj e llogaritë si pagesë të këstit pasues të radhës.

### *III. Pretendimet e debitorit në ankesë*

30. Lidhur me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, debitori ka parashtruar ankesë me datë 22.02.2024, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

31. Me ankesë debitori ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit Telekomit i Kosovës të ndryshohet aktvendimi aktvendimin KPPP.nr. 2074/23 të datës 16.02.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ashtu që: (III.) Aprovohet në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit i dt.18.07.2019 dhe plotësimi i prapësimit me parashtrësën e dt.10.10.2022, ndryshohet pika I. e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP2074/23 i dt.16.02.2024 ashtu që të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.491/19 i datës 15.07.2019 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34.

32. Sipas ankesës së debitorit (pika 4.) Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar ka refuzuar propozimin e caktimit të një ekspertize të pavarur nga një grup ekspertësh dhe ka refuzuar të caktojë seancë dëgjimore për ballafaqimin e palëve. Debitori në ankesë pretendon se kërkesa ka të bëjë me verifikimin përmes ekspertizës financiare, provave dhe dokumenteve në shkresat e lëndës se në procedurën përmbarimore është detyruar të paguaj më shumë se detyrimet e tij dhe atë:

- a) Ta njohë pagesën e Telekomit të Kosovës në vlerë 10,443,038.00€ si kompensim për dhënien në shfrytëzim të 90,000 numra shtesë Dardafonit për 70 muaj (nga 06/2017 deri me 12/2023) dhe shfrytëzim shërbimet 3G & 4G për Dardafon (200,000+90,000) për 70 muaj (nga 06/2017 deri me 12/2023), kjo sipas dokumentit “Marrëveshja për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit 20990/MHM”, të nënshkruar nga

Kreditori dhe Debitori me dt.24.05.2017, Akt Noterial (“*Act en minute*”) Nr. LRP 6316/2017 dhe Nr. Ref 1202/2017.

- b) Ta zbresë shumën prej 5,887,076.77 € si kamatë e mbingarkuar paligjshëm sepse nuk zbatohet kamata për periudhën deri kur është bërë njohja e vendimit të arbitrazhit nga Gjykata vendore Kosovare;
- c) Ta zbres shumën prej 2,509,731.36 € si kamatë shtesë e ngarkuar paligjshëm, e kërkuar gjatë periudhës në procedurën përmbarimore kur vetë Dardafon.net ka kërkuar përmbarimin e shumave të pasakta dhe Gjykatat i kanë dhënë të drejtë Telekomit.

33. Kreditori “Dardafon.net” L.L.C me datë 05.03.2024 ka parashtruar përgjigje në ankesë me propozim që Dhomat e Shkallës së Dytë me aktvendim të refuzojnë si të pabazuar ankesën e ushtruar nga debitori me datë 22.02.2024 dhe Aktvendimin e Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 ta vërtetojnë.

34. Lidhur me aktvendimin KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024, të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, që ka të bëjë me parregullsitë në procedurën e përmbarimit, debitori ka parashtruar ankesë me datë 20.03.2024, me të cilën ka kërkuar që të:

- I. APROVOHET e bazuar ankesa e debitorit Telekomit i Kosovës Sh.A., e parashtruar kundër aktvendimit KPPP.nr.2074/2023 e datës 15.03.2024 e paraqitur për parregullsitë në procedurën përmbarimore të ndërrmarra nga përmbaruesi privat Irfan Kërcagu gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P.nr.977/23;
- II. DETYROHET Përmbaruesi Privat Irfan Kërcagu që sipas Aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të vazhdojë përmbarimin sipas Marrëveshjes Nr.01-156/09 të datës 17.11.2020 për pagesën e borxhit me këste mujore deri në një vendosje ndryshe nga ndonjë vendim tjetër gjyqësor.
- III. DETYROHET Përmbaruesi Privat Irfan Kërcagu që të bëjë njoftimin e menjëhershëm të të gjitha Bankave Komerciale në republikën e Kosovës të liroj menjëherë llogaritë bankare dhe bllokimi eventual i radhës të realizohet nga data 15 deri me datë 20 të secilit muaj pasues sipas kushteve nga marrëveshja Nr.01-156/09 e datës 17/11/2020 deri në vendosjen ndryshe nga ndonjë vendim tjetër gjyqësor.
- IV. DETYROHET Përmbaruesi Privat Irfan Kërcagu që të përmirësojë urdhrin përmbarimor ashtu që të precizoj shumën e përmbarimit sipas aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 në vlerën prej 5,732,871.34 / 10 këste dhe ta përpjestojë të njëjtin me 10 këste për secilin këst mujor.
- V. DETYROHET përmbaruesi privat Irfan Kërcagu që të kthejë në xhirollogarinë bankare të Telekomit të Kosovës Sh.A., të gjitha mjetet e tërhequr në lartësinë më të lartë sesa vlera e një këstit, përkatësisht shumës prej EUR 573,287.13.

#### IV. Procedura në Dhomat e Shkallës së Dytë

35. Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate pas pranimit të ankesës së debitorit ndaj aktvendimeve të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr. 2074/23 të datës 16.02.2024 dhe KPPP.nr.2074/2023 e datës 15.03.2024, me qëllim të dhënies së mundësisë debitorit që të paraqesë pretendimet ankimore për të cilat ka theksuar në ankesë se nuk iu ka dhënë mundësia për tu deklaruar në seancë publike, si dhe rreth pretendimit se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar trajtimin e provave të Telekomit për pagesat e bëra, me datë 12.04.2024, ka vendosur që të mbajë seancë dëgjimore.

36. Gjykatës Kushtetuese e Kosovës në aktgjykimin në rastin nr. KI84/21 të parashtruesit Telekomi i Kosoves Sh.A, të datës 17.12.2021, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ, ndër të tjera kishte konstatuar se “defektet në instancë të parë mund të përmirësohen përmes institucionit të ankesës, me kusht që institucioni që vendos për ankese, të ketë "juridiksion të plote". Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, *“koncepti i "juridiksionit të plotë" nënkupton që gjykata që e shqyrton ankesën jo vetëm që duhet të ketë të drejtë të vlerësojë ankesën, por po ashtu duhet të ketë kompetencë që të prish vendimin në fjale dhe ose të marrë vendimin vet apo të kthejë rastin për një vendim të ri nga një trupë e pavarur* (Shih rastet e GJEDNJ, M.S. kundër Finlandës, Aktgjykim i 22 qershorit 2005, paragrafi 35; Koksoy kundër Turqisë, Aktgjykim i 13 janarit 2021, paragrafi 36; Bacaksiz kundër Turqisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2019, paragrafi 59).

37. Duke trajtuar konceptin e gjykatës së *"juridiksionit të plotë"*, Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte konkluduar se “Gjykata e Apelit kishte juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që lidhen me kontestin para saj, [dhe se] kualifikohet si një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë", në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-se dhe nenit 31 të Kushtetutës (Shih Aktgjykimin në rastin nr. KI84/21 të parashtruesit Telekomi i Kosovës Sh.A, të datës 17.12.2021, parag.128).

38. Nisur nga fakti se kjo çështje ishte kthyer në rivendosje tri herë nga gjykatat e shkallës së dytë, përfshirë këtu dy vendime nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, kjo Gjykatë me qëllim që debitorit t’i jepet mundësia që të deklarohet para gjykatës në dëgjim publik, e drejtë kjo e përcaktuar edhe me Nenin 6 të KEDNJ, ka mbajtur katër seanca dëgjimore lidhur me pretendimet ankimore të debitorit (seancat e dt.12.04.2024; 02.05.2024; 15.05.2024; 28.05.2024).

39. Seanca e datës 12.04.2024 është mbajtur në mungesë të palës kreditore, pasi që ndonëse i autorizuari i debitorit Av. A.M. me parashtrësën e datës 03.04.2024 kishte kërkuar shtyrjen e seancës së datës 12.04.2024 me arsyetimin se kishte të caktuar një seancë tjetër, Gjykata konform nenit 20 par.2 dhe 5 të LPP-së ka vlerësuar se i autorizuari i kreditorit ka qenë i ftuar në afatin e rregullt ligjor dhe nuk ka pasur arsye për shtyrjen e seancës. Sipas gjykatës i autorizuari i kreditorit nuk ka arritur të argumentojë se ftesën për seancë nuk e ka pranuar me kohë, e as nuk kishte dhënë ndonjë arsye për mungesën e z. Lekë Sahatxhiu.

40. Në seancën e datës 12.04.2024 të autorizuarit e debitorit kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë ankesës me të gjitha pretendimet ankimore, në veçanti faktit se Gjykata e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë mundësinë e trajtimit të provave për pagesat e bëra. Kjo konsiston në mos nxjerrjen e një ekspertize për të zbardhur drejtë detyrimin e paguar deri më tani, për shkak se ekspertiza e nxjerrë para përmbartuesi privat nuk i ka përfshirë kompensimet sipas marrëveshjes të viti 2017. Debitori në asnjë rast nuk e konteston vendimin e arbitrazhit si dokument përmbartimor. Sa i përket kompensimeve të cilat nuk janë marr parasys, i autorizuari i debitorit ka deklaruar se bëhet fjalë për kompensimet referuar në ankesë pika 6. a), b), c). Sa i përket pretendimit nga pika a, në vlerë 10,443,038 € këtë e mbështesim në marrëveshjen e nënshkruar mes palëve me dt.24.05.2017 në pikën 8.4. Më tej ka shtuar se është e vërtetë se nuk e kemi kundërshtuar shkëputjen e marrëveshjes sepse njëra palë e ka pasur të drejtën që të del nga kjo marrëveshje. Mirëpo, ajo që debitori kërkon është që, shuma prej 10,443,038 € të njihet si kompensim në kryegjë.

41. Lidhur me pretendimin që shuma prej 10,443,038 € të zbritet në kompensimin e dëmit material, këtë pretendim debitori e mbështet në pikën VI, 5 të vendimit të arbitrazhit. Në bazë të kësaj pike Telekomit nuk ka pasur obligim që kreditorit t'i jepen numrat sipas marrëveshjes së vitit 2017. Por këtë e kemi bërë me qëllim të kompensimit të detyrimit. Fakti se me vendimin e Gjykatës Komerciale KPPP.nr.1996/22 të dt.27.10.2022 është shfuqizuar pika II (c) e diapozitivit të urdhrimit përmbartues, nënkupton se ky detyrim nuk është në fuqi dhe rrjedh se kompensimi prej 10,443,038 euro i takon zbatimit të detyrimeve nga dëmi material. Pra duhet të kuptohet drejtë pika 5 e vendimit përfundimtar të arbitrazhit se Telekomit i Kosovës do të detyrohej të paguajë dënime shtesë përmes dhënies së numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g vetëm kur shuma agregate e këtyre ndëshkimeve shtesë të tejkalojë vlerën 17,315,000 euro. Pra, sipas një kalkulimi të thjeshtë i bie që kjo shumë nuk do të arrihej për 5 vitet e ardhshme. Pra, Telekomit nuk do të kishte asnjë detyrim shtesë sikur të mos jepte numra dhe shërbime 5 vitet e ardhshme dhe e vetmja arsye që numrat dhe shërbimet e dhëna sipas marrëveshjes së vitit 2017 ishte kompensimi nga borxhi që ka dal nga vendimi i arbitrazhit, kompensimet që deri tani nuk janë përfshirë në borxhin kryesor. Vlen të theksohet se këto numra dhe shërbime janë shfrytëzuar nga debitori për 30 muaj, 12 muaj sa formalisht ka qenë në fuqi marrëveshja e vitit 2017 dhe 18 muajt tjerë pasi që kreditori deklarativisht ka dal nga marrëveshja por i ka shfrytëzuar shërbimet për 18 muajt e ardhshëm.

42. Sa i përket pretendimit për shumën 5,887,076.77 € si kamatë e ngarkuar paligjshëm, i autorizuari i debitorit ka deklaruar se këtë pretendim e gjejmë në neni 39 të Ligjit mbi Arbitrazhin i cili kërkon që për tu ekzekutuar një vendim i arbitrazhit të huaj duhet të kalojë në procedurën e njohjes. Telekomit si kompani publike nuk mund të bëjë pagesa para se një vendim i huaj i arbitrazhit të njihet në vendin tonë. Ne nuk mund të bartim detyrime për konsumim të periudhave në të cilat nuk kemi ndikim. Më tej ka deklaruar se debitori ka bërë padi për anulim kurse pala tjetër ka bërë kërkesë për njohje, ndërsa me marrëveshje janë pajtuar që të dy palët të tërhiqen nga procedurat përkatëse, e tërë kjo me qëllim të zbatimit të vendimit. Kreditori pasi që ka marrë benefitet e marrëveshjes deklarohet se del nga marrëveshja dhe inicion përsëri procedurën e njohjes. Kjo ka mundur të jetë e qëllimshme nga kreditori për tu rritur kamata. Nuk ka qenë në vullnetin çështja e pagesës sepse ne kemi nënshkruar marrëveshje. Kamata nga pika b) e ankesës

në shumën prej 5,887,076.77 euro rrjedh në mënyrë të paligjshme nga data 14.04.2015 si ditë e inicimit të procedurës së arbitrazhit, siç rrjedh nga vendimi përfundimtar i arbitrazhit deri në vendimin për njohjen e vendimit të huaj në vitin 2019. Duhet theksuar se për periudhën 12 mujore sa marrëveshja ka qenë në fuqi nuk është llogaritur kamata.

43. Sa i përket pretendimit rreth kamatës 2,509,731.36, i autorizuari i debitorit ka deklaruar se kamata nga pika c) e ankesës në shumën prej 2,509,731.36 euro rrjedh në mënyrë të paligjshme për periudhën nga data e njohje së vendimit të huaj deri në fund të vitit 2023 kur deri kur debitori ka bërë kalkulimin për kumatën e paligjshme. Më tej ka deklaruar se marrëveshjen e vitit 2020 debitori e kundërshton sa i përket mos përfshirjes.

44. Në seancën dëgjimore të datës 12.04.2024 pala debitore i ka propozuar gjykatës që deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër procedura përmbartimore të pezullohet. Pasi që, në këtë rast me mbajtjen e bllokuar të xhirollogarive bankare është duke u cenuar interesi publik, operacionet ditore si dhe pagesat e ndërsjella që ka Telekom i me operatorët e ndryshëm.

45. Lidhur me propozimin e debitorit për pezullimin e procedurës përmbartimore, gjykata konform nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, me aktvendim e ka hedhur poshtë si të palejuar propozimin e debitorit për pezullimin e procedurës përmbartimore.

46. Ndonëse debitori ka kërkuar gabimisht pezullimin e procedurës përmbartimore, e cila rregullohet me dispozitat e nenit 65 të LPP-së, gjykata në esencë këtë propozim e ka trajtuar si kërkesë për shtyrjen e përmbartimit.

47. Për këtë propozim të debitorit, Gjykata ka vlerësuar se në këtë fazë të procedurës së shqyrtimit të ankesës ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, nuk kanë tagër për të vendosur pezullimin dhe/apo shtyrjen e përmbartimit. Së pari çështja e shtyrjes dhe/apo pezullimit të procedurës është veprim procedural i cili inicohet dhe vendoset nga organi përmbartues – në këtë rast përmbartuesi privat si organ i shkallës së parë. Përmbartuesi privat konform Nenit 3 dhe 5 të LPP-së është i autorizuar për të drejtuar procedurën përmbartimore dhe për të vepruar në procedurën e shkallës së parë. Drejtimi i procedurës nënkupton edhe debitimin e borxhit, gjë të cilën e zhvillon dhe ndërmer veprime vetëm përmbartuesi privat. Gjykata nuk ka mundësi të ndërhyjë në aspektet e tërheqjes, bllokimit apo kalkulimit të mjeteve nga debia, prandaj dhe me Ligj nuk ka autorizime të ndërhyjë në procedurën e zhvilluar nga përmbartuesi i cili ka kompetencë të zbatojë përmbartimin. Andaj, gjykata e shkallës së dytë mund të vendos vetëm si gjykatë ankimore, rreth pretendimeve ankimore që fillimisht janë konsumuar në shkallë të parë dhe nuk mund të ndërhyjë drejtpërdrejtë në rolin dhe veprimet përmbartimore që përmbartuesi i zhvillon në procedurën përmbartimore.

48. Së dyti, me nenin 60 par.1 të LPP-së shtyrja e përmbartimit i është lejuar si mundësi vetëm palës kreditore dhe atë vetëm deri në fazën kur ende të mos ketë filluar të zbatohet aktvendimi për përmbartim, apo urdhri për përmbartim. Andaj, gjykata në seancën e datës 12.04.2024 e ka hedhur poshtë si të palejuar propozimin e debitorit për pezullimin e përmbartimit.

#### *4.1. Ekspertiza financiare*

49. Kjo Gjykatë sqaron se në procedurën e përmbarimit, në shkallë të dytë, gjykata shqyrton vetëm pretendimet ankimore dhe në këtë fazë nuk zhvillohet procedurë e të provuarit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të debitorit se në këtë çështje përmbarimi debitori ka paguar më tepër nga se është përcaktuar në urdhrin për përmbarim, i cili mbështetet në dokumentin përmbarues – vendimin e arbitrazhit, gjykata ka caktuar ekspertizë sipas detyrës zyrtare duke zbatuar përshtatshmërisht dispozitat e nenit 356 të LPK-së, lidhur me Nenin 21 të Ligjit Nr.04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Pra, në këtë proces përmbarimi, gjykata e ka caktuar ekspertizën sipas detyrës zyrtare dhe jo si mjet provues siç zhvillohet procedura kontestimore.

50. Gjykata vë theksin në faktin se në përcaktimin e detyrimit që rrjedh nga borxhi në procedurën e përmbarimit, kur organi përmbarues dhe/apo gjykata sipas detyrës zyrtare nxjerr mjetin provues, i takon asaj që në këtë procedurë të përcaktojë lartësinë e borxhit sa herë që një gjë e tillë kërkon ekspertimin. Rrjedhimisht, në procedurën përmbarimore palët kanë të drejtë të japin vërejtjet në ekspertizë, mirëpo nuk i takon diskrecionit të palëve për të përcaktuar vëllimin e ekspertimit, ngase kjo do të shpiente në hapjen e procesit kontestimor mes tyre – gjë që nuk është as qëllimi dhe as mundësi e përcaktuar me Ligjin e Procedurës Përmbarimore. Qëllimi i procedurës përmbarimore dhe ekspertimit në llogaritjet që duhet të bëhen, i takon organit përmbarues me qëllim të kalkulimit të shumave që duhet ekzekutuar nga dokumenti përmbarues.

51. Me qëllim të gjetjes së të vërtetës materiale lidhur me pagesën e borxhit për të cilën debitori ka pretenduar se ka paguar më tepër, gjykata jashtë seancës ka vendosur me konkluzionin e datës 15.04.2024 që të caktohet nxjerrja e ekspertizës financiare me qëllim të verifikimit të shumës së mbetur të detyrimit për pagesë nga ana e debitorit. Për këtë qëllim, gjykata ka angazhuar ekspertët financiar gjyqësor z.B.U, z. L.M dhe z.B.P, për të bërë ekspertizën financiare dhe me konkluzion ka përcaktuar detyrat e ekspertëve.

52. Ekspertët financiar pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pas llogaritjeve të bëra, kanë ardhur në përfundim se bazuar në detyrimin e përcaktuar në dokumentin përmbarimor – Vendimi Përfundimtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr.20990/MHM, datë 09.12.2016, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit, Telekomit i Kosovës Sh.A. deri në vendosjen sipas aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.04.2024 të Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është në shumë të përgjithshme prej 5,733,705.20 €.

53. Sipas ekspertizës së grupit të ekspertëve shuma e përgjithshme e borxhit të mbetur në shumë prej 17,281,141.99 €, përbehet nga interesat deri në marrëveshje në shumë prej 7,645,964.45 € dhe nga borxhi kryesor në shumë prej 9,635,177.53 €. Bazuar në të dhënat, Debitori dhe Kreditori e kanë përpiluar planin e pagesave me këste mujore, bazë për llogaritjen e kamatës - interesit i cili në total është në shumë prej 718,224.43 €, është marr vetëm borxhi i mbetur e i cili është në shumë prej 9,635,177.57 €, respektivisht nuk është llogaritur interesi –

kamata në shumën 7,645,964.40 € e cila siç është cekur më lartë është e përbërë nga interesi i llogaritur deri në arritjen e marrëveshjes, pra nuk është llogaritur kamatë mbi kamatë.

54. Nga ekspertiza e grupit të ekspertëve rezulton se gjatë llogaritjes së pagesës së kësteve, bazë për llogaritjen e kamatës së dakorduar me marrëveshje, është marrë shuma prej 9,635,177.57 € e cila shumë në përmban edhe shumën prej 1,660,000.00 €. Në këtë kategori, ekspertët kanë konstatuar se shuma 1,660,000.00 e përbënë 17.23 % të shumës totale të borxhit – kryegjësë sipas marrëveshjes, andaj nga kamata të cilën e ka paguar Debitori në shumë prej 582,988.79 € duhet të aplikohet norma prej 17.23 % dhe me atë rast vihet deri te shuma prej 100,448.97 € që do të thotë së Debitori ka paguar më shumë në emër të kamatës shumë prej 100,448.97 €. Kjo shumë është llogaritur si pagesë e kryegjësë.

55. Gjithashtu, gjatë përllogaritjes së kësteve sipas marrëveshjes, palët janë dakorduar që, interesi i bartur i papaguar në shumë të përgjithshme prej 7,645,964.45 të paguhet në 24 këste, respektivisht për çdo muaj nga 318,581.85 € ( $7,645,964.45/24$ ). Pasi që, siç e kemi cekur më lartë në shumën e interesit të bartur të papaguar është përfshi edhe shuma prej 30,380.27 € i bie që kësti i përcaktuar për pagesë të interesit të bartur ka qenë më i madh, respektivisht kësti është dashur që të jetë në shumë prej 317,316.01 € ( $7,645,964.45 - 30,380.27 = 7,615,584.13$ ;  $7,615,584.13/24 = 317,316.01$ ). Bazuar në këto llogaritje, ekspertët kanë konstatuar se debitori, përmes pagesave të 14 kësteve sipas marrëveshjes, në emër të interesit të bartur, e ka paguar shumën prej 4,460,145.90 € ( $318,581.85 * 14$ ) ndërsa shuma e cila është dashur të paguhet shuma prej 4,442,424.08 € ( $317,316.01 * 14$ ), apo për 17,721.82 € më shumë. Kjo shumë është trajtuar si pagesë e kryegjësë, ndërsa për diferencën në shumë prej 12,658.45 € ( $30,387.20 - 17,721.82$ ) do të zvogëlohet interesi i bartur i papaguar.

56. Bazuar në llogaritjet e grupit të ekspertëve është konstatuar se borxhi i mbetur i papaguar i debitorit, pas ndërprerjes së pagesave të kësteve sipas marrëveshjes, është në shumë të përgjithshme prej 5,573,671.13 € i cili përbëhet nga borxhi kryesor – kryegjësja në shumë prej 2,400,511.03 € dhe nga borxhi nga interesi i bartur në shumë prej 3,173,160.10 €. Sipas konstatimit të grupit të ekspertëve debitori e ka ndërprerë pagesën e kësteve ndaj Kreditorit, respektivisht pagesën e fundit e ka realizuar me 16.02.2022, që nga ajo datë është llogaritur kamata me normë prej 8 %.

57. Ekspertiza sqaron se në harmoni me pikën 3 të konkluzionit të Gjykatës, me të cilën është përcaktuar që borxhi i papaguar i debitorit të llogaritet deri në vendosjen sipas aktvendimit të ankimuar – KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, ekspertët kanë bërë llogaritje të kamatës për periudhën prej pagesës së fundit 16.02.2022 deri me datën 10.01.2023 (data e plotësimit të ekspertizës në bazë të cilës është përpiluar urdhri i përmbaruesit), respektivisht për 10 muaj aq muaj sa është llogaritur kamata nga përmbaruesi).

58. Gjykata e shih të nevojshme të sqarojë se në konkluzion ka kërkuar llogaritjen e kamatave deri me vendosjen sipas aktvendimit të ankimuar – KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, pasi që objekt ankimi ka qenë shuma e përcaktuar nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ndërkaq debitori nuk ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë



59. Me datë 24.04.2024, para se debitorit ta kishte pranuar ekspertizën me shkrim, i njëjti ka parashtruar kërkesë për ofrimin e sqarimeve dhe/apo në mënyrë alternative plotësimin e Konkluzionit K.Dh.SH.II.Nr712/2024 të datës 15.04.2024 lidhur me caktimin e detyrave të grupit të ekspertëve. Me parashtrësë debitori ka ngritur shqetësimet se konkluzioni nuk përcakton se si do të llogariten kompensimet përkatëse për 90,000 numrat shtesë, si dhe pranimin e shërbimeve 3G dhe 4G sipas marrëveshjes së vitit 24.05.2017 për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Po ashtu në parashtrësë debitori kërkon që të definohet saktë se deri në cilën datë ekspertët financiarë duhet të llogarisin kamatat. Deri në këtë fazë debitori nuk kishte ngritur çështjen e konfliktit të mundshëm të interesit të grupit të ekspertëve.

60. Me konkluzionin e marr në seancën e datës 02.05.2024, Gjykata e ka përmirësuar pikën II.2 të konkluzionit K.Dh.Shk.II.nr.712/24 të datës 15.04.2024, duke përcaktuar këtë pikë të konkluzionit si në vijim: I. PËRMIRËSOHET pika II. 2 e konkluzionit të kësaj Gjykate K.Dh.Shk.II.nr.712/24 e datës 15.04.2024 ashtu që e njëjta duhet të jetë si në vijim: “Te llogariten kamatat ligjore për borxhin e mbetur sipas vendimit të arbitrazhit, të cilat rrjedhin nga dita e përcaktuar në vendimin përfundimtar të arbitrazhit, deri në kalkulimin sipas plotësim – ekspertizës së kryer tek përmbaruesi privat te vitit 2023, duke përjashtuar nga llogaritja kamatat për periudhat kur palët e kanë eliminuar kamatën sipas marrëveshjes në mes tyre për pagesat vullnetare, e cila i referohet marrëveshjes së datës 24.05.2017”. II. Pjesa tjetër e konkluzionit mbetet e pandryshuar.

61. Gjykata sqaron se qëllimi i konkluzionit ka qenë llogaritja e pjesës së mbetur të borxhit sipas dokumentit përmbarimor, duke mos anashkaluar pagesat që janë bërë përfshirë edhe sipas marrëveshjeve që palët kanë bërë përgjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore.

62. Palët ndërgjyqëse para inicimit të procedurës së përmbarimit me datë 24.05.2017 kishin lidhur marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit. Sipas kësaj marrëveshje, respektivisht me Nenin 8 të saj palët kishin rregulluar modalitetet e marrëveshjes dhe mënyrat e zbatimit në rast të mos përmbushjes.

63. Gjatë procedurës së përmbarimit palët kishin lidhur një marrëveshje të re të datës 17.11.2020 e titulluar “*marrëveshje për ekzekutimin e borxhit në procedurën përmbarimore*”, me të cilën ishin dakorduar për obligimet për borxhin e mbetur dhe të pa ekzekutuar nga marrëveshja e arbitrazhit. Pjesë e kësaj marrëveshje ishte aneksi me (tabelat) e llogaritjeve të dyja palëve, e nga e cila ishte eliminuar kamata për periudhën sa ishte në fuqi marrëveshja e vitit 2017.

64. Qëllimi i plotësimit të konkluzionit të gjykatës në seancën e datës 02.05.2024 ishte pikërisht reflektimi i llogaritjes së kamatave të eliminuara nga vet palët me marrëveshjet e tyre, respektivisht eliminimi i kamatave nga llogaritja e grupit të ekspertëve, për kohën sa ishte në fuqi marrëveshja e vitit 2017, për të cilën vet palët ishin dakorduar me marrëveshjen e vitit 2020 që t'i eliminojnë.

65. Duhet theksuar se në marrëveshjen mes palëve të datës 12.11.2020 e cila në faqe të parë mban vulë protokollit të vet Telekomit dhe është e nënshkruar dhe e vulosur nga debitori, palët ishin pajtuar për ekzekutimin e borxhit. Sipas nenit 2 të marrëveshjes (Obligimet nga marrëveshja), theksohej se “*palët bien dakord që borxhi i mbetur i papaguar dhe pa-ekzekutuar nga vendimi i arbitrazhit është 17,281,141.98€ (borxhi i mbetur)*”.

66. Pjesë e marrëveshjes për ekzekutimin e borxhit, e nënshkruar, vulosur dhe protokolluar nga palët, ishte aneksi i saj, respektivisht shumat e kalkuluar në tabelën e dorëzuar dhe bashkangjitur si aneks nga vet debitori Telekomit të Kosovës.

67. Në tabelën që është aneks i marrëveshjes dhe nënshkruar nga përfaqësuesi i debitorit rrjedh se borxhi total është në shumë 17,281,141.98 €, i cili përputhet me aneksin e kreditorit dhe me vet marrëveshjen.

68. Marrëveshja për ekzekutimin e borxhit, e lidhur mes palëve ishte arritur para përmbauesit privat Ilir Mulhaxha në seancën e datës 18.12.2020 (procesverbali i lëndës P.nr.491/19).

69. Marrëveshjet e lidhura në një procedurë gjyqësore janë të detyrueshme për palët dhe tani pretendimet e debitorit se e njëjta është lidhur nën presion për shkak të bllokimit të llogarive, është justifikim i cili nuk ka asnjë bazë të vetme ligjore që gjykata ta anashkalojë apo në çfarëdo forme ta abrogojë.

70. Vlen të theksohet për palët se marrëveshjet e lidhura mes palëve janë të detyrueshme dhe gjykata nuk ka asnjë të drejtë ligjore që një marrëveshje të arritur mes palëve, ta anuloj në të njëjtën procedurë, apo të mos e përfill siç pretendon debitori. Ndërkaq, duhet nënvizuar se debitori nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik që pretendimet e veta për lidhje të një marrëveshje nën presion t'i vërtetojë në një procedurë gjyqësore të ligjshme. Andaj, duhet sqaruar për palët se një akt marrëveshje e lidhur mes palëve, nuk mund të anulohet apo në çfarëdo mënyre të mos trajtohet, vetëm me deklaratë të thjeshtë apo se ashtu pretendon njëra palë.

71. Duke u nisur nga detyrimet që rrjedhin nga dokumenti përmbaues, e mbi bazën e marrëveshjes së arritur nga vet palët, Gjykata në seancën e datës 02.05.2024 lidhur me propozimin e palëve që të plotësohet ekspertiza me llogaritjen e kompensimeve të dhënies së 90,000 numrave shtesë dhe shërbimeve 3g dhe 4g, përkatësisht të hyrat financiare nga këta numra që i ka gjeneruar kreditori, ka vendosur me aktvendim që të refuzojë si të pabazuar propozimin e debitorit që të kullohen të hyrat nga 90.000 numrat dhe shërbimet 3g dhe 4g.

72. Gjykata vlerëson se qëllimi i debitorit që të bëhet zbritja e detyrimeve nga fitimet, respektivisht kompensimet reciproke si pasojë e përfitimit të kreditorit nga 90,000 numrat dhe shërbimet 3g dhe 4g, është kërkesë e parashtruar gjatë fazave të ndryshme të procedurës përmbauese, përfshirë këtu edhe pretendimet në ankesë (shih ankesën e debitorit të datës 22.02.2024, fq.2, pika 6 (a). Po ashtu debitori, të njëjtën kërkesë të plotësimi të ekspertizës me këto parametra e ka bërë edhe në seancën e datës 28.05.2024 të cilën gjykata me aktvendim e ka

hedh poshtë si kërkesë për të cilën veçse ishte vendosur njëherë. Po ashtu të njëjtën kërkesë debitori e ka bërë edhe me parashtrësën e datës 31.05.2024 (pika 1, fq.1)

73. Debitori në vazhdimësi dhe në mënyrë të përsëritur ka parashtruar kërkesat për plotësim ekspertizë, respektivisht për marrjen parasysh në llogaritjen e borxhit të vlerës financiare të 90,000 numrave dhe shërbimeve 3G dhe 4G për 290,000 numra që kreditori i ka pranuar dhe ka mbajtur në shfrytëzim,

74. Kërkesa e tillë nuk është përfshirë në konkluzion për ekspertizë, është refuzuar me aktvendim në seancën e datës 02.05.2024, është hedhur poshtë si kërkesë e përsëritur me aktvendimin e seancës së datës 28.05.2024 dhe është refuzuar me aktvendimin e veçantë të datës 04.06.2024.

75. Lidhur me kërkesën e debitori për llogaritjen e vlerës financiare të 90.000 numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g për 90,000 numrat mobil, gjykata sqaron si në vijim:

76. Së pari, objekt përmbartimi në këtë procedurë përmbartimore ka qenë ekzekutimi i dokumentit përmbartimor – vendimit të Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit OEN nr.20990/MHM.

77. Ky vendim si i tillë ishte njohur dhe ishte shpallur i ekzekutueshëm me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2018.

78. Në gjykatën e shkallës së parë në këtë procedurë përmbartimore ka qenë në shqyrtim prapësimi kundër urdhrorit për përmbartim ndaj ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit dhe gjykatës as në shkallës të parë dhe as në procedurën ankimore nuk i takon të lëshohet në trajtimin e vendimit të arbitrazhit i cili kërkon të ekzekutohet.

79. Megjithatë, në mënyrë që pretendimi për kompensim të kërkesave nga 90,000 numrat dhe shërbimet 3g dhe 4g të jetë i qartë për debitorin, kjo Gjykatë thekson se vendimi i arbitrazhit në pikën IV. 1) a) dhe b), ka përcaktuar detyrimin në bërje (apo në natyrë), ashtu që siç theksohet në dispozitivin e vendimit të arbitrazhit lidhur me këtë pjesë të detyrimit, debitori është “urdhëruar [...] menjëherë” që ta përmbush këtë detyrim.

80. Së pari, detyrimi për dhënien e numrave sqarohet qartësisht në pikat IV. B deri në pikën IV E, të arsytimit të vendimit të arbitrazhit, gjë që trajton në detaje detyrimet që rrjedhin nga pika VI. 1) a) dhe b) e dispozitivit të vendimit të arbitrazhit. Andaj, gjykata në këtë procedurë nuk ka tagër që të lëshohet në interpretime të palëve lidhur me mënyrën se si duhet të ekzekutohen detyrimet e dala nga vendimi i arbitrazhit, por ekzekuton vendimin si të tillë.

81. Së dyti, duhet rikujtuar se palët me datë 16.11.2020 kanë lidhur marrëveshje për ekzekutimin e borxhit, e arritur dhe aprovuar edhe para përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha në seancën e datës 18.12.2020 duke mos bërë ndonjë zbatim të kërkesave siç pretendon tani debitori me ankesë.

82. Së treti, nuk ekziston asnjë mundësi ligjore dhe është juridikisht e pamundur që me prapësim procedural, pra qoftë me prapësim apo ankesë në procedurën e përmbarrimit, apo në mënyrë analoge edhe me përgjigje në padi në kontest juridiko-civil, njëra palë të realizojë një kërkesë, qoftë kompensuese apo tjetër. Arsye për këtë është fakti se palët kërkesat e tyre nuk mund t'i realizojnë përmes kundërshtimeve, e që është juridikisht e njohur, por duhet të ekzistojë kërkesë legjitime në procedurën përkatëse në të cilën vërtetohet me vendim gjyqësor.

83. Ajo çka debitori kërkon tani me ankesë janë kompensime të vlerës financiare që kreditori ka përfituar me numrat e telefonisë mobile dhe shërbimet 3G dhe 4g. Gjykata rikujton se në procedurën e përmbarrimit bëhet debitimi direkt i kërkesave që rrjedhin nga dokumenti përmbarrimor e që në rastin konkret objekt përmbarrimi është vendimi i arbitrazhit. Për më tepër, palët as në marrëveshjen e bërë para Përmbarruesit Privat P.nr.491/19 të datës 18.12.2020 nuk kishin përfshirë kërkesa të tilla, e kjo kërkesë nuk mund të realizohet me mjetin ankimor – qoftë me prapësim apo me ankesë.

84. Gjykatës nuk i takon të jep udhëzime se si njëra palë që ka statusin e debitorit në procedurë, mund të veprojë kur ka kërkesë kompensuese ndaj palës tjetër, por gjykata trajton vetëm pretendimet ankimore, sepse do të ishte ndërhyrje në parimin e barazisë së armëve.

85. Andaj, gjykata me aktvendime në seancat e mbajtura në shkallës të dytë ka refuzuar, respektivisht ka hedhur poshtë kërkesën e palës debitore që në këtë procedurë vlerat financiare të kreditorit nga përfitimi i numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g të kalkulohej në detyrimin përfundimtar.

86. Debitori në seancën e datës 02.05.2024 përsëri ka ngritur kërkesën për përmirësim të ekspertizës dhe atë me llogaritjen e 10,443.038€ si shumë e kompensuar në emër të detyrimeve nga vendimi i arbitrazhit. Po ashtu debitori ka propozuar që të përmirësohet ekspertiza edhe sa i takon përfshirjes së shumës 3,853,336.12 € si kamata të llogaritura me marrëveshjen e vitit 2020. Më tej, është propozuar që nga data e lidhjes së marrëveshjes të mos përfshihen kamatat në llogaritjen e ekspertizës.

87. Gjykata në seancën e datës 02.05.2024 me konkluzion e ka kthyer ekspertizën financiare në plotësim. Me nenin 356 të LPK-së është përcaktuar diskrecioni i gjykatës që të caktojë ekspertizë sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo rrethanave të caktuara nevojitet dijëni profesionale. Në këtë kuptim, gjykata ka kërkuar plotësimin e ekspertizës ashtu që ekspertët *“të sqarojnë interesin e kalkuluar në shumën prej 1,728,506.93 euro duke llogaritur sipas bazës së saktë nga rrjedha pagesave si dhe të japin sqarime për kamatën në shumën prej 110 mijë euro si dhe kamatën e vendosur në shpenzimet e procedurës duke i qartësuar Gjykatës shumën e borxhit sipas kalkulimit të qartë tyre. Në këtë pjesë ekspertët kanë për obligim të marrin parasysh interesi sipas marrëveshjes për ekzekutimin e borxhit në shumë prej 681,795.04 euro i cili ndikon në llogaritjen e kryegjësë”*. Me pikën II të konkluzionit të marr në seancën e datës 02.05.2024 gjykata e ka refuzuar propozimi për eliminimin e shumës prej 160,034.07 €.

88. Gjykata ka vlerësuar të nevojshme të kërkohen sqarime nga ekspertët lidhur me atë se a janë llogaritur të gjitha kompensimet e bëra deri në kohën e llogaritjes së kamatës, respektivisht se mbi cilën bazë është llogaritur kamata. Deri te ky vlerësim ka ardhur pikërisht për të sqaruar se si dhe pse është kalkuluar shuma prej 1,728,506.93€, si dhe të jepen sqarime për kamatën prej 110.000 €, e në këtë pjesë janë obliguar ekspertët të marrin parasysh interesin në shumën prej 681,795.04€.

89. Siç rrjedh nga konkluzioni, gjykata ka kërkuar vetëm sqarime nga ekspertët për të qartësuar nëse dhe si janë kalkuluar shumat prej 1,728,506.93€. Kjo për faktin se për gjykatën ka qenë e nevojshme të sqarohen nëse janë përfshirë pagesat para datës 17.11.2020 si dhe të jepen sqarime për kërkesën e debitorit që të zvogëlohet llogaritja e kamatës për 110.000 €, e që sipas debitorit kamata është llogaritur mbi bazë të borxhit në shumë 1,477,851.21€. Qëllimi i ekspertizës plotësuese ka qenë të sqarohen këto dy kategori për të cilat nuk ka qenë e qartë për gjykatën mënyra e llogaritjes.

90. Gjykata, nga ana tjetër e ka refuzuar propozimi për eliminimin e shumës prej 160,034.07€, si kamatë e ngarkuar gjatë procedurës gjyqësore, respektivisht pas vendosjes nga Gjykata e Apelit për çështjen. Deri te ky vendim gjykata erdhi pasi që për gjykatën ishte e qartë se kjo kategori ka të bëjë me shumën e kamatës së llogaritur në kryegjënë e mbetur pas pagesës së kësteve vullnetare, respektivisht kamatë kjo e akumuluar prej pagesës së fundit vullnetare deri në vendimin e gjykatës, të cilën debitori ka kërkuar të mos llogaritet.

91. Deri te ky vlerësim gjykata ka ardhur bazuar në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, pasi që borxhi edhe në këtë fazë që pretendon debitori ende nuk ishte përmbushur nga debitori dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që të ndalet llogaritja e kamatave. Në këtë drejtim, gjykata thekson se ky pretendim për mos llogaritje të kamatës por edhe pretendimet tjera të debitorit sikurse në ankesë (shih ankesën e debitorit të datës 22.02.2024 fq.2 pika 6 b dhe c) që kamata të caktuara gjatë rrjedhës së procedurës të mos kalkulohen janë të pabazuara në ligj.

92. Gjykata vë theksin në dispozitën e nenit 382 të LMD e cila thekson se kamata fillon të llogaritet me mospërmbushjen e obligimit nga debitori. Këtu duhet përmendur edhe llogaritjen e kamatëvonesës së zbatuar nga vet vendimi i arbitrazhit. Pra, edhe arbitrazhi i cili kishte vendosur për çështjen në fjalë, kamatëvonesën e ka llogaritur me fillimin e procedurës ndaj debitorit (d.m.th. nga data 13.04.2015 kur kreditori kishte iniciuar procedurën e arbitrazhit) (Shih arsyetimin e vendimit të arbitrazhit në pikën. IV.F.3).

93. Pretendimet e debitorit që kamatat të mos llogariten në periudha të caktuara që debitori i konsideron si të padrejta i referohen fazave të procedurës kur detyrimi ka qenë ekzistent dhe në këtë rast nuk pushon apo nuk ndalet llogaritja e kamatës. Në këtë funksion të zbatimit të kamatës ka gjykuar edhe arbitrazhi, duke filluar kamatën e llogaritur nga data e inicimit të procedurës. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se asnjë veprim i debitorit apo fazë procedurale pavarësisht mënyrës së vendosjes nuk paraqet bazë që kamata të ndalet së llogarituri. Debitori këtë pretendim nuk ka qenë në gjendje të mbështet në asnjë dispozitë ligjore apo praktikë gjyqësore.

94. Ne ekspertizën plotësuese të datës 08.05.2024, grupi i ekspertëve ka gjetur si në vijim:

(i) Interesi i kalkuluar në shumën prej 1,728,506.93 €

Duke qenë se palët me datën 17.11.2020 kanë lidhur Marrëveshjen për ekzekutimin e borxhit në procedurën përmbarimore Nr.01-156/09, ku është i përfshirë edhe interesi i llogaritur në shumë prej 1,728,506.93€. ky interes është llogaritur nga ana e ekspertit Remzi Smajli me kërkesë të përmbaruesit privat Ilir Z. Mulhaxha sipas Konkluzionit përmbarimor P.nr.491/16 datë 13.07.2020.

Si bazë për llogaritjen e kamatës është marr shuma prej 21,546,151.90 €, respektivisht nuk janë marrë parasysh pagesat dhe kompensimet të cilat Debitori i ka realizuar para datës 08.07.2019. Obligimi total i Debitorit të dalë nga Vendimi i Arbitrazhit është në shumë prej 27,577,851.22 € e përbërë nga dëmi kolateral në shumë 8,785,000.00 €, fitimi i humbur në shumë prej 17,315,000.00 €, 75% e shpenzimeve të arbitrazhit në shumë prej 972,121.22 € dhe 505,730.00 €. Debitori, para datës 08.07.2019 ka bërë pagesa dhe kompensime në shumë të gjithmbarshme prej 10,471,305.66 € (4,500,000.00 + 5,971,305.66). Nga gjithsejtë pagesa dhe kompensime në shumë prej 10,471,305.66 € , shuma prej 8,993,454.44 € (3,022,148.78 + 5,762,851.11 +208,454.55) është trajtuar si pagesë e dëmit material dhe fitimit të humbur, në këtë rast kryegjësë, ndërsa shuma prej 1,477,851.22 € (972,121.22 + 505,730.00) është trajtuar si pagesë e shpenzimeve të procedurave juridike. Andaj, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit me datë 08.07.2019 ka qenë në shumë prej 17,106,545.56 €.

Bazuar në të gjitha llogaritjet, grupi i ekspertëve ka ardhur në përfundim se debitori, për periudhën prej 09.07.2019 deri më 15.07.2020 është ngarkuar me kamatë më shumë për shumën prej 333,737.63 € (1,728,506.93 – 1,394,769.30). Kjo llogaritje e gabueshme, ka ndikuar edhe në përcaktimin e borxhit total të papaguar të Debitorit në datën e arritjes së Marrëveshjes nr.01-156/09 të datës 17.11.2020, respektivisht si e tillë ka ndikuar në përcaktimin jo të drejtë të kësteve për pagesë të borxhit të mbetur.

(ii) Kamata e vendosur mbi shpenzimet e procedurës

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe llogaritjeve, grupi i ekspertëve nuk ka hasur në llogaritjen e kamatës mbi shpenzimet e procedurës.

(iii) Zvogëlimi i borxhit kryesor me interes

Gjatë barazimit të kërkesave dhe obligimeve të ndërsjella në mes të Debitorit dhe Kreditorit sipas marrëveshjes, përveç tjerash është trajtuar edhe shuma prej 681,795.84 € e e cila ka të bëjë me llogaritjen e interesit të debitorit ndaj kreditorit.

(iv) Ndikimi i përmirësimeve në borxhin e mbetur të papaguar

Bazuar në sqarimet dhe llogaritjet nën pikën 1 dhe 3 të raportit, grupi i ekspertëve konstatoi se pas eliminimit të shumës prej 1,660,000.00 € dhe kamatës mbi atë shumë prej 30,380.27 € të shtjelluar në ekspertizën e datës 24.04.2024, rezulton se borxhi i papaguar i Debitorit deri me datën e marrëveshjes është (dashur të jetë) në shumë prej 15,257,024.09 € nga e cila kryegjëja është në shumë prej 8,656,972.61 € ndërsa interesi i grumbulluar në shumë prej 6,600,051.48 €.

Debitori, deri me datë 15.02.2022, sipas marrëveshjes dhe kësteve të përcaktuara i ka paguar gjithsejtë 14 këste dhe atë kryegjënë në shumë prej 5,456,495.69 €, interes në shumë prej 582,988.78 € dhe obligimin për interesin e bartur në shumë prej 4,460,145.93 apo në total 10,499,630.40 €.

Grupi i ekspertëve e ka bërë analizimin dhe llogaritjet e obligimeve të dala nga marrëveshja të cilat Debitori i ka paguar përmes 14 kësteve deri me datë 15.02.2022 në shumë prej 10,499,630.40 € dhe obligimeve pas korigjimeve të bëra të cilat debitori ka pasur obligim ti paguan deri me datë 15.02.2022 në shumë prej 9,276,359.91 €. Shuma e paguar e interesit deri më datën 15.02.2020 prej 59,187.54 € dhe shuma më shumë e paguar e interesit të bartur prej 610,115.90 € do të trajtohen si pagesë e kryegjësë andaj në vazhdim do të paraqitet borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit pas pagesës së fundit të këstit, respektivisht pas datës 15.02.2022. Pas llogaritjes së kamatës i bie që borxhi total i mbetur i papaguar nga ana e Debitorit është në shumë të përgjithshme prej 5,449,939.83 €.

95. Pas pranimit të ekspertizës plotësuese, debitori në seancën e datës 28.05.2024 përsëri ka parashtruar kërkesë për plotësimin e ekspertizës me kërkesën e njëjtë dhe të përsëritur për përfshirjen e kompensimeve të 90,000 numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g, të cilën gjykata në seancë e ka hedhur poshtë si kërkesë të përsëritur e për të cilën tashmë ishte vendosur disa herë.

96. Në seancën e datës 28.05.2024 debitori ka shfrytëzuar të drejtën për të parashtruar pyetje dhe ka dhënë vërejtje në ekspertizë, duke theksuar se nga pyetjet e bëra drejtuar ekspertëve qartësisht konstatohet se të njëjtit kanë operuar pa pasur detyra të qarta dhe vëllim të saktë të detyrave të ekspertizës. I autorizuari i debitorit, pas përfundimit të pyetjeve të parashtruara ekspertëve ka deklaruar se nuk kanë pyetje të tjera për ekspertët dhe njëherit ka kërkuar nga gjykata që kërkesat për plotësim ndryshim të ekspertizës t'i dërgojnë në formë të shkruar.

97. Gjkata me aktvendim në seancën e datës 28.05.2024 me qëllim që debitorit t'i jepet mundësia që vërejtjet dhe kërkesat e veta ndaj ekspertizës dhe plotësim ekspertizës t'i paraqesë me shkrim, e ka aprovuar kërkesën e debitorit që në afat prej 3 ditësh të dorëzojë me shkrim propozimet për korigjim të ekspertizës.

98. Debitori Telekom i Kosovës me datë 31.05.2024 ka dorëzuar me shkrim parashtresën për plotësimin dhe korigjimin e ekspertizës financiare. Sipas parashtresës kërkesa e debitorit për ri-plotësim dhe korigjim të ekspertizës financiare është përmbledhur në 5 pika si në vijim: (i) të plotësohet ekspertiza duke përfshirë vlerën financiare të 90.000 numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g për numrat që kreditori ka pranuar dhe ka mbajtur në shfrytëzim për 30 muaj sipas marrëveshjes së datës 24.05.2017; (ii) të korigjohet ekspertiza financiare ashtu që shuma e

kamatave të kalkuluara dhe të përfshira si detyrime të debitorit në ekspertizë për periudhën pas marrëveshjes së datës 24.05.2017 të mos përfshihet në ekspertizë; (iii) të korrigjohet ekspertiza financiare që lidhet me trajtimin e pagesës në vlerë prej 4,500.000€; (iv) të korrigjohet ekspertiza financiare që lidhet me pikën 2, tabela 5 e plotësimit të ekspertizës financiare – të evitohet mos përfshirja në kompensim e të gjitha detyrimeve që kreditori kishte ndaj debitorit, dhe (v) të korrigjohet plotësim ekspertiza e datës 08.05.2024 lidhur me trajtimin e kompensimeve të interesit të llogaritur në favor të debitorit në vlerë prej 681,795.04€.

99. Gjykata me aktvendim të veçantë K.Dh.Shk.II.712/24 të datës 04.06.2024 e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e debitorit për korrigjimin e ekspertizës, në të cilin ka dhënë arsye të detajuara për propozimet e debitorit.

100. Përkitazi me këto kërkesa të debitorit për plotësimin e ekspertizës gjykata ri-përsëritë se, ekspertiza në këtë procedurë gjyqësore është nxjerrë *ex-officio* nga gjykata me qëllim të evidentimit të borxhit të mbetur sipas dokumentit përmbartimor, duke u bazuar në marrëveshjen për ekzekutimin e borxhit të datës 18.11.2020, që palët kishin lidhur para organit përmbartues – përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha, po në këtë procedurë përmbartimore me datë 18.12.2020.

101. Asgjë në këtë procedurë dhe asnjë veprim nuk mund të jetë faktor që gjykata *ex-officio* apo në çfarëdo mënyre të anashkalojë, anulojë apo në çfarëdo mënyre ta zhbëjë një akt juridikisht të ligjshëm që palët me vullnetin e tyre e kanë lidhur në procedurë para organit përmbartues, përderisa nuk ka një vendim apo akt tjetër të formës së prerë që e lë jashtë fuqie.

102. Pretendimet e vazhdueshme të debitorit se marrëveshja e vitit 18.12.2020 e lidhur tek përmbartuesi privat Ilir Mulhaxha, ka qenë e lidhur nën presion, për shkak se debitori i ka pasur llogaritë e bllokuara, nuk është arsye dhe as shkas i ligjshëm që gjykata ta merr parasysht.

103. Së pari, gjykata sqaron se debitori i llogarive bankare të debitorit sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore, paraqet mjet të ligjshëm për zbatimin e përmbartimit. Së këndejmi, arsyetimi se bllokimi i llogarive bankare nga përmbartuesi privat ndaj një subjekti juridik është formë presioni apo çfarëdo forme tjetër e trysnisë për të lidhur marrëveshje – e që tani debitori e sheh si marrëveshje të lidhur në dëm të saj – nuk është arsye e thjeshtë deklarative që gjykata të mund ta merr parasysht.

104. Së dyti, palët në procedurë duhet ta kenë dijeninë e mjaftueshme se një akt, marrëveshje apo veprim tjetër juridik i dakorduar në një procedurë gjyqësore, paraqet formë të dakordimit mes palëve dhe e njëjta ka fuqi provuese, respektivisht ekzekutive në procedurën e tillë. Së këndejmi, hyrja në një marrëveshje qoftë në gjykatë apo në procedurë para organit përmbartues nënkupton veprim konkludent mes palëve, e cila nuk zgjidhet e as nuk zhbëhet me prapësim apo kundërshtim deklarativ.

105. Së treti, edhe sikundër një marrëveshje e lidhur mes palëve para procedurave tek organi përmbartues të ishte juridikisht e pavlefshme apo nule, e njëjta duhet që si e tillë të vendoset dhe të vërtetohet me vendim gjyqësor, e që pala duhet ta ketë të njohur se gjykata në procedurën



përmbartimore nuk ka as kompetencë as autorizime ligjore që të vendos ligjshmërinë e marrëveshjeve të lidhura mes palëve.

106. Së fundi, pritshmëria që gjykata të zgjedh në mënyrë selektive pjesëzat e marrëveshjeve të dakorduara mes palëve, vetëm për aq sa njëra palë synon të zbatojë debinë nuk gjen mbështetje. Në këtë drejtim, gjykata vë theksin në faktin se vet debitori ka pasur qëndrime kontradiktore për veprimet e veta në procedurë. Kështu, debitori me prapësimin fillestar të datës 18.07.2019 (pika 22) nuk e kundërshton shkëputjen e marrëveshjes për ekzekutim të vitit 2017 nga ana e kreditorit. Ndërkaq në anën tjetër në disa deklarime gjatë procesit gjyqësor debitori kërkon që vetëm kjo marrëveshje të merret si bazë nga gjykata, ndërkaq jo edhe ajo e vitit 2020 e lidhur dhe dakorduar tek përmbartuesi privat nga po të njëjtat palë.

107. Kjo mënyrë kontradiktore e veprimit ku njëra palë kundërshton një veprim të vetin, qoftë marrëveshje apo veprim tjetër juridik të ndërmarr në procedurë nuk mund të merret si prapësim i mjaftueshëm që gjykata në procedurën përmbartimore të anulojë veprime të palëve.

108. Gjykata ka vlerësuar se çështja në fjalë i takon procedurës përmbartimore, në të cilën gjykata e shkallës së dytë nuk ka për detyrim mbajtjen e seancës e as shqyrtimin e fakteve, ngase në këtë procedurë gjykata kufizohet në shqyrtimin rigoroz formal ta dokumentit përmbartimor mbi të cilin mbështetet urdhri për përmbartim që duhet ekzekutuar. Duke synuar që palëve t'i jepet e drejta për tu dëgjuar në një shqyrtim publik para gjykatës, të mbështetur në Nenin 6 të KEDNJ, gjykata në procedurën e shkallës së dytë sipas ankesës ka mbajtur seancat e datës 12.04.2024; 02.05.2024; 15.05.2024 dhe 28.05.2024.

109. Duke qenë se gjykata ka dëgjuar pretendimet ankimore të palëve si dhe vërejtjet e debitorit lidhur me ekspertizën e nxjerrë në Dhomat e Shkallës së Dytë, pasi që ka përfunduar ballafaqimin e ekspertëve dhe palët kanë deklaruar se nuk kanë pyetje të tjera për ekspertë, ka gjetur se propozimi për korrigjim e ekspertizës është i pabazuar dhe të njëjtin e ka refuzuar me aktvendim të veçantë. Duke qenë se nuk ka pasur çështje të tjera për shqyrtim dhe në këtë procedurë të përmbartimit sipas ankesës në shkallë të dytë nuk zhvillohet procedurë e administrimit të provave e as e dhënies së fjalës përfundimtare, gjykata vlerësoi se janë marrë dhe dëgjuar në shqyrtim publik pretendimet ankimore të debitorit.

110. Sa i takon ekspertizës plotësuese gjykata sqaron se e njëjta ka arritur të sqarojë shumën e borxhit të mbetur në këtë proces gjyqësor që ka qenë qëllimi për përcaktimin e borxhit të mbetur bazuar në dokumentin përmbartues – vendimin e arbitrazhit, borxh ky të cilin palët e kanë konfirmuar me marrëveshjen e vitit 2020 për pagesë.

111. Gjykata rithekson se qëllimi i nxjerrjes së ekspertizës si dhe asaj plotësuese ka qenë përcaktimi i borxhit përfshirë kamatat i cili rrjedh nga dokumenti përmbartues, duke mos anashkaluar dakrodimin e palëve me marrëveshjen e datës 16.11.2020 për shumën e mbetur të borxhit, gjithnjë me qëllim që në ekspertizë të sqarohen pagesat e bëra nga debitori. Rrjedhimisht, edhe arsyeja e kthimit të ekspertizës në plotësim ishte që të merren parasysh pagesat e bëra nga debitori në të holla (bazën e saktë të borxhit në momentin e lidhjes së

marrëveshjes), e të cilat debitori për arsye të cilat gjykata nuk mund t'i ketë në dijeni, ishte dakorduar me kreditorin për pagesën e borxhit të mbetur me bazë më të lartë sesa kishte për të paguar.

112. Pra, duhet përsëritur se qëllimi i nxjerrjes së ekspertizës ishte identifikimi i borxhit të mbetur me kamata duke përfshirë pagesat e bëra nga Telekom i ndaj kreditorit, që debitori kishte hyrë në një marrëveshje me bazë më të lartë të borxhit. Gjykata në procedurën e përmbarimit merr parasysh pagesat reciproke të kryera nga palët ngase qëllimi i procedurës është përmbarimi i borxhit dhe pagesave të kryera, andaj dhe ekspertiza ka pasur qëllim vetëm kalkulimin e pagesave që debitori kishte kryer.

113. Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë edhe sa i përket pretendimeve të debitorit se meqë ekspertiza financiare është e mundur të prekë marrëveshjet për zbatim të borxhit, atëherë do të duhej t'i ndryshonte kategoritë tjera të borxhit, përfshirë kompensimet dhe kamatat. Gjykata vë në pah se qëllimi i ekspertizës ka qenë përcaktimi i lartësisë së borxhit për ekzekutim marr parasysh marrëveshjen që palët kanë bërë mes vete në vitin 2020. Ndonëse debitori kishte pranuar borxh me bazë më të lartë sesa në realitet kishte – gjë që evidentohet nga aneksi marrëveshja e vitit 2020 (tabela e përgatitur nga Telekom i Kosovës), në procedurën e përmbarimit pagesat e bëra në emër të një borxhi, gjithmonë duhet të merren parasysh në debitimin e atij borxhi, pra të zbriten pagesat e kryera për atë borxh. Mirëpo, këtu nuk mund të bëhen kompensime apo zbatim i kërkesave të tjera të cilat nuk janë ekzekutim i drejtpërdrejtë i mjeteve monetare – siç është për shembull kërkesa e debitorit që të kompensohet apo zbatohet fitimi që kreditori kishte nga numrat e pranuar dhe shërbimet 3g dhe 4g – kërkesa këto të cilat nuk i takojnë zbatimit të procedurës së përmbarimit. Lidhur me këtë kërkesë gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme në pikat 75 – 85 të arsyetimit.

114. Prandaj, ekspertiza, përfshirë edhe ekspertizën plotësuese ka qenë mjaftueshëm e qartë për të nxjerrë shumën e borxhit dhe kamatat e sakta që debitori i detyrohet kreditorit, përfshirë këtu shumën që palët ishin dakorduar me marrëveshjen e vitit 2020, gjithnjë duke zbritur nga shuma e borxhit pagesat e kryera monetare e të cilat kishin pasur implikime në kamatë, ndonëse vet debitori kishte arritur marrëveshje për ekzekutimin e borxhit me bazë më të lartë borxhi.

115. Kreditori Dardafon.net, përmes përfaqësuesit me prokurë në seancën e datës 15.05.2024, nuk e ka kundërshtuar ekspertizën plotësuese, andaj zbritja e shumës së borxhit, ndonëse palët kishin lidhur marrëveshje për ekzekutimin e borxhit merret si fakt i mirëqenë nga Gjykata.

116. Grupi i ekspertëve në ekspertizën plotësuese bazuara në konkluzionin e gjykatës ka gjetur se në kohën e përpilimit të ekspertizës nga ana e ekspertit Remzi Smajli, borxhi bazë mbi të cilin ishte kalkuluar interesi, ishte llogaritur gabimisht dhe atë për bazën prej 21,546,151.90 euro. Duke qenë se kjo shumë sipas grupit të ekspertëve ishte llogaritur gabimisht, të njëjtit në ekspertizën plotësuese kanë llogaritur shumën bazë prej 17,281,141.99 euro, si shumë e saktë mbi të cilën do të duhej të kalkulohej kamatat.

117. Sipas grupit të ekspertëve obligimi total i debitorit të dalë nga Vendimi i Arbitrazhit është në shumë prej 27,577,851.22 € e përbërë nga dëmi material në shumë 8,785,000.00 €, fitimi i humbur në shumë prej 17,315,000.00 €, 75% e shpenzimeve të arbitrazhit në shumë prej 972,121.22 € dhe 505,730.00 €. Debitori, para datës 08.07.2019 ka bërë pagesa dhe kompensime në shumë të prej 10,471,305.66 € (4,500,000.00 + 5,971,305.66). Nga gjithsejtë pagesa dhe kompensime në shumë prej 10,471,305.66 € shuma prej 8,993,454.44 € (3,022,148.78 + 5,762,851.11 + 208,454.55) është trajtuar si pagesë e dëmit material dhe fitimit të humbur, në këtë rast kryegjësë, ndërsa shuma prej 1,477,851.22 € (972,121.22 + 505,730.00) është trajtuar si pagesë e shpenzimeve të procedurave para arbitrazhit. Andaj, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit me datë 08.07.2019 ka qenë në shumë prej 17,106,545.56 €. Sipas ekspertizës plotësuese rrjedh se debitori, për periudhën prej 09.07.2019 deri më 15.07.2020 është ngarkuar me kamatë më shumë për shumën prej 333,737.63 € (1,728,506.93 – 1,394,769.30).

118. Sa i takon kërkesës nga konkluzioni që të llogaritet kamata e vendosur mbi shpenzimet e procedurës, grupi i ekspertëve nuk ka hasur në llogaritjen e kamatës mbi shpenzimet e procedurës. Sepse interesi është llogaritur vetëm mbi bazën e kryegjësë, respektivisht borxhit kryesor të dalë nga vendimi i arbitrazhit dhe atë për dëmin në shumë prej 8,785,000.00 € dhe fitimin e humbur në shumë prej 17,315,000.00 €. Prandaj, edhe gjykata kësaj pjese ia ka falur besimin duke ardhur në përfundim se ekspertët në të gjitha ekspertizat pa përjashtim, përfshirë këtu edhe ekspertizën e grupit të ekspertëve, vinë në përfundimin se nuk është llogaritur kamatë në shpenzime të procedurës.

119. Bazuar në sqarimet dhe llogaritjet e kryera nga ekspertët, si dhe pas eliminimit të shumës prej 1,660,000.00 €, e cila ishte vendosur me aktvendimin e Gjykatës Komerciale dhe kamatës mbi atë shumë prej 30,380.27 € të shtjelluar në ekspertizën e datës 24.04.2024, ekspertët kanë konstatuar se borxhi i papaguar i debitorit deri me datën e marrëveshjes është në shumë prej 15,257,024.09 € nga e cila kryegjësja është në shumë prej 8,656,972.61 € ndërsa interesi i grumbulluar në shumë prej 6,600,051.48 €. Debitori, deri me datë 15.02.2022, sipas marrëveshjes dhe kësteve të përcaktuara i ka paguar gjithsejtë 14 këste dhe atë kryegjënë në shumë prej 5,456,495.69 €, interes në shumë prej 582,988.78 € dhe obligimin për interesin e bartur në shumë prej 4,460,145.93 apo në total 10,499,630.40 €.

120. Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pas llogaritjeve të bëra, grupi I ekspertëve ka ardhur në përfundim se, bazuar në detyrimin e përcaktuar në dokumentin përmbartimor – Vendimi Përfundimtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr.20990/MHM, datë 09.12.2016, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit, Telekomit i Kosovës Sh.A. deri në vendosjen sipas aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.04.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është në shumë të përgjithshme prej 5,449,939.83 €.

#### *4.2. Kërkesat për përjashtimin e ekspertëve*

121. Pas pranimit të ekspertizës financiare, në seancën e datës 02.05.2024 debitori mbi bazën e nenit 360 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, paraqet kërkesë për përjashtimin e ekspertëve, me arsyetimin se ka mësuar për shkakun e përjashtimit të tyre pasi që është kryer

ekspertiza financiare. I autorizuari i debitorit ka theksuar se ka arsye dhe dyshime serioze për anshmërinë e ekspertëve gjyqësor, dhe këto dyshime debitori i bazon se eksperti financiar Z.B.U ka lidhje të ngushta familjare me I.I i cili është bashkëshort i vajzës së Z. B.U, i njëjti është ortak në biznes me B.D, pronar me 90% të aksioneve të kreditorit në procedurën tonë. Për këtë debitori ka dorëzuar parashtrësën me shkrim në seancën e datës 02.05.2024. Po ashtu, në seancën e datës 15.05.2024 pala debitore ka kërkuar përsëri përjashtimin e grupit të ekspertëve nën pretekstin se ekzistojnë lidhjet e z.B.U, jo vetëm në “Klubin e Biznesit”, por dhëndri i tij është aksionar në një biznes tjetër “Prokon Group” së bashku me z. A.K, që është anëtar bordi në Korporatën Devolli. Ndërsa lidhja qëndron në atë se i njëjti biznes sipas disa informatave, ka gjeneruar të hyra në shumë rreth 300000€. Kjo ndërlidhje bëhet për të dokumentuar se vajza e ekspertit përfiton të hyra direkt nga kreditori. Po ashtu debitori ka ndritur dyshime edhe për anësinë e ekspertit B.P, për të cilin ka pretenduar se i njëjti është palë në një procedurë kundër debitorit në lëndën C.nr.544/08, e po ashtu edhe ndërlidhja me pozitën e tij si zv.Drejtor në Shoqatën e kontabilistëve, ku anëtare e Bordit është znj. Sh.M, e cila në web faqen e të njëjtës shoqatë ka të deklaruar se punon në Birra Peja që i takon Korporatës Devolli e ndërlidhur me kreditorin. Ndërsa ka bashkangjitur prova – emaila për përfshirjen e znj. Sh.M me rastin e zhvillimit të procedurës te Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha (shih procesverbalin e dt.23.12.2022 në shkresat e lëndës).

122. Në seancat gjyqësore të datës 02.05.2024 dhe 15.02.2024 ekspertët janë deklaruar lidhur me pretendimet e debitorit për konfliktin e mundshëm të interesit. Eksperti B.U ka deklaruar se “I.I është dhëndër imi dhe është aksionar së bashku me gjashtë aksionarët tjerë në kompaninë Klubi i Biznesit, nuk jam i sigurt për emrin e saj, në të cilin është aksionar edhe Z. B.D, do të thotë nuk është ortak si po e potencojnë përfaqësuesit e kreditorit dhe që nuk ka të bëjë asgjë me Dardafone këtu kreditor. Kështu, që unë kam qenë i bindur se nuk ka konflikt interesi sepse nuk lidhje të drejtpërdrejtë aq më tepër për faktin se ne jemi grupi i ekspertëve dhe të gjitha vendimet i kemi marrë së bashku. Ndërkaq, në pyetjen se a e njeh personalisht B.D dhe a e keni takuar ndonjëherë, eksperti B.U ka deklaruar: Asnjëherë, Nuk e njoh dhe nuk e di si duket. Ndërkaq Eksperti B.P ka deklaruar se pavarësisht deklaratave të debitorit apo edhe kreditorit mund të konkludojë se ekspertiza jonë financiare është përgatitur profesionalisht dhe e mbështetur në konkluzionet e gjykatës. Në PTK kam qenë i punësuar deri në vitin 2007, pra para 17 vitesh dhe këto rrethana kanë qenë të njohura edhe më herët dhe nuk kanë qenë kontestuese gjatë fillimit të punimit të ekspertizës, takimeve të mbajtura me debitorin apo edhe me kreditorin. Gjykata ka qenë e njoftuar dhe i kemi shpalosur faktin që po ngritët dhe nuk është kontestuese për gjykatën fakti që po ngritët se kam qenë punëtor i PTK. Sa i përket pozitës në SCAAK si zv.Drejtor nuk ka ndërlidhje me pozitën e znj. M, si anëtare e bordit. Unë raportoj te drejtori ekzekutiv dhe jo në Bord. Përzgjedhja ime është përgjegjësi ekskluzive e drejtorit ekzekutiv, pra ajo më ka zgjedhur si zv.drejtor. Kurrfarë lidhje pune, komunikimi çfarëdo qoftë me znj M. unë nuk kam. Prandaj nuk ndiej se kam konflikt interesi në këtë procedurë.

123. Gjykata pasi ka dëgjuar pretendimet e debitorit, ka shqyrtuar provat dhe dëshmitë e sjella nga debitori dhe deklaratat e ekspertëve me aktvendimet e marra në seancat e datës 02.05.2024 dhe 15.05.2024 i ka refuzuar propozimet për përjashtimin e ekspertëve.

124. Si rregull, me nenin 360 par2 të LPK-së kërkesa e palës për përjashtimin e ekspertit kufizohet në afat më së voni para fillimit të marrjes së provës me anë të ekspertimit. Për gjykatën fakti se ekspertët B.P dhe L.M kanë punuar në PTK, ka qenë fakt i njohur dhe i shpalosur nga ekspertët – gjë që nuk ka paraqitur pengesë që të njëjtit të angazhohen si ekspertë. Ky fakt nuk është ngritur nga palët si rrethanë e konfliktit të interesit, por debitori si rrethanë e ka parashtruar ekzistimin e kontestit që eksperti z.P. ka pasur me PTK. Një rrethanë e tillë në asnjë mënyrë nuk mund të paraqitet si rrethanë e kuptuar pas pranimit të ekspertizës, pasi që ekziston presupozimi se subjektet juridike e dinë apo duhet të dinë për kontestet që kanë qoftë me punonjës apo palë të treta. Andaj, Gjykata nuk e ka marr parasysh një kontest pune të vitit 2015 (i plotfuqishëm me datë 16.04.2020). Pra, për gjykatën gjetja e një dëshmie se eksperti ka pasur kontest me debitorin si subjekt juridik, në asnjë rrethanë nuk mund të arsyetohet si rrethanë e re e gjendur pas pranimit të ekspertizës. Kjo për faktin se subjektet juridike kanë organizim menaxherial dhe që nuk mund të thirren rrethana subjektive të mungesës së njohurive apo të ngjashme.

125. Sa i përket rrethanave personale që debitori ka ngritur për lidhjet e mundshme të familjarëve të tij me B.D, pronar të kreditorit, gjykata i ka trajtuar pretendimet e tilla dhe për arsytet në vijim ka vlerësuar se çështja e ngritur nuk paraqet rrethanë për përjashtimin e ekspertit. Duke qenë se Gjykata pranon, që situata mund të ketë ngjallur dyshime tek debitori në lidhje me mundësinë e anshmërisë së ekspertit. Megjithatë, duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe dyshimi mund të ketë një bazë të mjaftueshme faktike që eksperti të jetë ndikuar. Në rastin konkret, Gjykata sqaron se ekspertët i nënshtrohen detyrimeve të paanshmërisë të parapara me dispozitat ligjore, ngjashëm sikurse gjyqtarët, e që i nënshtrohen edhe përgjegjësiive civile si dhe atyre penale. Prandaj, për gjykatën fakti se dhëndri i ekspertit është pjesëtar i një biznesi me pronarin e këtu kreditorit nuk mund të merret apriori si lidhje që e ndërlihd vet ekspertin.

126. Duke qenë se dispozitat për përjashtimin e gjyqtarit vlejné përshtatshëmrisht edhe për përjashtimin e ekspertit, gjykata duke vlerësuar rrethanat e ngritura nga debitori i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ në rastet për përjashtimin e gjyqtarëve. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ “*Gjykata pohoi se ka rëndësi themelore, që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët* (shih Padovani v. Italy, vendimi i dt. 26 shkurt 1993, Seria A nr.257-B p.20). *Neni 6 kërkon, që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi, apo anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm* (shih Piersack v. Belgium, vendimi i datës 1 tetor 1982, Seria A nr.53, § 30 dhe Kyprianou v. Cyprus [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005-...). *Veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie* (shiko Castillo Algar v. Spain, vendimi i datës 28 tetor 1998, Raporti 1998-VIII, p.31116, § 45 dhe Morel v. France, nr. 34130/96, § 42, ECHR 2000-VI). *Në përcaktimin, nëse në një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar që një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo*

*vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (shiko Ferrantelli dhe Santangelo v. Italy, vendim i datës 7 gusht 1996, Reports 1996-III, pp. 951-52, § 58, dhe Wettstein v. Switzerland, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII; Kyprianou v. Cyprys [GC], nr 73797/01, §§ 118 -119, ECHR 2005)*

127. Në çështjen konkrete, ndonëse debitori vuri në dyshim si paanshmërinë subjektive ashtu edhe atë objektive të ekspertëve, Gjykata vlerëson se pretendimet sado që mund të ngjallin dyshime subjektive, nuk mund të jenë të asaj natyre të cilat duhet të merren bindëse në pa një lidhje të qartë faktike. Lidhur me ndërlidhjen që debitori ka pretenduar për ekspertin B.P se i njëjti punon në shoqatën e auditorëve ku anëtare e bordit është znj.Sh.M – e punësuar në Korporatën Devolli, gjykata këtë pretendim nuk e mori si dyshim subjektiv që eksperti të jetë nën konflikt të mundshëm të interesit. Kjo për faktin se raporti profesional shtrihet në një organizëm jofitimprurës (shoqatë e auditorëve) ku janë të anëtarësuar të gjithë auditorët, e ku eksperti nuk ka vartësi qoftë menaxheriale apo financiare nga znj.M.

128. Gjykata lidhur me pretendimet për konfliktin potencial të interesit për z. B.U ka marr parasysh dy faktor. Së pari, fakti se rrethana për përjashtim ka qenë subjektive – pra lidhje e dhëndrit të ekspertit me pronarin e kreditorit, e njëjta duhet të vlerësohet në prizmin subjektiv. Këtu gjykata ka konsideruar se ndërlidhja që i bëhet ekspertit nuk është e drejtpërdrejtë që e implikon atë, andaj gjykata ka qenë e prirur që të merr si të besueshëm deklarin e z. U se nuk e njeh dhe nuk e ka takuar ndonjëherë pronarin e kreditorit B.D. Ky fakt duhet analizuar edhe në konteskt se sa eksperti beson në paanësinë e tij dhe jo çdo pretendim i palëve duhet të merret si i mirëqenë. Andaj, në këtë pjesë gjykata ka vlerësuar se eksperti nuk lidhje të drejtpërdrejtë, apo të tërthorta të asaj natyre që e bëjnë të jetë nën konflikt të interesit apo të anshmërisë.

129. Indikative për gjykatën ka qenë fakti se debitori ka qenë i gatshëm të vazhdojë ekspetim nga të njëjtit ekspertë nëse do të ndryshohej konkluzioni i gjykatë. I autorizuari i debitorit gjatë deklarimeve të tij rreth përjashtimit të ekspertit ka deklaruar se “*nëse konkluzioni mbetet siç ka qenë në fillim dhe u lihet hapësirë ekspertëve që vetë të vendosin çfarë të përfshihet si pagesë dhe kompensim dhe çka jo, atëherë në këtë rast kërkojmë që eksperti B.U të përjashtohet si eksperti*”. Këtë mënyrë të veprimit të debitorit, gjykata e ka vlerësuar si kusht jo të domosdoshëm për përjashtim të ekspertëve – gjë që nuk do të duhej të ishte kur për palën ekziston prezumimi i konfliktit të interesit.

130. Nisur nga fakti se gjykata është ajo që cakton detyrat e ekspertëve dhe ekspertët i shërbejnë detyrave për të cilat janë caktuar, gjykata ka vlerësuar se ekspertët kanë vepruar konform detyrave të dhëna, përkatësisht në asnjë mënyrë nuk kanë vepruar jashtë detyrave – kjo Gjykatë ka vlerësuar se nuk është plotësuar asnjë rrethanë ligjore që ekspertët të përjashtohen. Pavarësisht pritshmërisë së palëve, Gjykata është e bindur se ekspertet kanë vepruar konform detyrave të dhëna në konkluzionet e gjykatës, qëllimi i të cilave ka qenë vlerësimi i drejtë i detyrimit në këtë çështje përmbare.

## V. *Vlerësimi i Gjykatës për pretendimet ankimore*

5.1.Vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të debitorit në pikën I. të aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024

131. Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore të parashtuara me ankesë dhe ato në shqyrtim, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është pjesërisht e bazuar:

132. Fillimisht sa i takon përmbartueshmërisë së vendimit të arbitrazhit, Gjykata vëren se pretendimet e debitorit në ankesë sa i përket vlefshmërisë së dokumentit përmbartimor, ekzekutueshmërisë së tij dhe tipareve të përmbartimit, debitori ka mbajtur qëndrime kontradiktore në raport me titullin ekzekutiv.

133. Në prapësim si dhe në ankesën e datës 22.02.2024 debitori e atakon titullin ekzekutiv për arsye se i njëjti nuk disponon klauzolën e përmbartueshmërisë. Në anën tjetër, i autorizuari i debitorit në seancën e datës 12.04.2024 thekson “*debitori në asnjë rast nuk e konteston vendimin e arbitrazhit si dokument përmbartimor*”.

134. Sidoqoftë, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe LPK-së në mënyrë analoge, ngase me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka trajtuar vendimin final të arbitrazhit 20990/MHM si dokument përmbartues i cili i plotëson kushtet ligjore për të qenë i përmbartueshëm.

135. Në arsyet e dhëna në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftueshme për përshtatshmërinë e dokumentit përmbartimor. Kështu, me të drejtë gjykata e shkallës së parë i referohet Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me numër IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019, me të cilin është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm Vendimi i Tribunalit të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) Rasti OEN-it, nr.20990/MHM, Vendi i Arbitrazhit: Londër, Angli, Vendimi përfundimtar i datës 09 dhjetor 2016, në çështjen juridike të Dardafon.net.L.L.C me seli në fshatin “Miradi”, Komuna e Fushë Kosovës, (Republika e Kosovës), si paditës dhe Telekom i Kosovës sh.a (ish-PTK sh.a) me seli në Prishtinë, Republika e Kosovës, si i paditur, në tërësi si në dispozitivin e vendimit të lartcekur.

136. Gjykata e shkallës së parë drejtë i referohet dispozitave të LPP-së dhe atë sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 22 par. 1, pika 1.5, të LPP-së, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: “*aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit*

*dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarrim brenda territorit të Republikës së Kosovës”.*

137. Me nenin 23. par.1 të LPP-së, përcaktohet se: “ *vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdite gjyqësore konsiderohet ujdite e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit*”, ndërsa me nenin 24 par. 1 të LPP-së, përcaktohet se: “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.*”. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se: “*Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

138. Sipas nenit 39 par.1 të Ligjit për Arbitrazhin (NR. 02/L-75 – tutje LA) përcaktohet se: “*Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm sipas paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni.*” Sipas par.2 të këtij neni përcaktohet se: “*Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit të nxjerrur jashtë Kosovës i paraqitet Gjykatës Ekonomike.*” Ndërsa me par.3 të këtij neni është përcaktuar se: “*Kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pala e interesuar ia bashkëngjet: a). origjinalin e vendimit ose një kopje të vërtetuar të vendimit; b). origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar të saj; dhe c). një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit të arbitrazhit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, nëse marrëveshja ose vendimi nuk është përpiluar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.*”

139. Duke u bazuar në të lartcekurat, sipas Dhomave të Shkallës së Dytë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se urdhri për përmbarrim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv - Vendimit Përfundimtar Rasti i OEN – nr. 20990/MHM i datës 9 dhjetor 2016, i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.5, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së dhe nenit 39 të LA-së, pasi që dokumenti përmbarrimor, është i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe i njëjti vendim është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm me datën 11.02.2019.

140. Në raport me vendimet e arbitrazhit edhe GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se "posedimet" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 mund të jenë ose "pasuri ekzistuese" (shih Van der Mussele kundër Belgjikës, 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70, f. 23 , § 48) ose asete, duke përfshirë pretendimet, në lidhje me të cilat një aplikant mund të argumentojë se ai ka të paktën një "pritje legjitime" që ato do të realizohen (shih, për shembull, Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës, aktgjykimi e 20 nëntorit 1995, Seria A nr. 332, f. 21, Ouzounis dhe të tjerët kundër Greqisë, 18 prill 2002 par. 24; Ostapenko kundër Ukrainës, 14.09.2007, par.44).



141. Kështu, GJEDNJ ka vendosur vazhdimisht se një “kërkesë” mund të përbëjë një “posedim” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 2002, § 40, dhe Stran Greek Rafineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendimi i 9 dhjetorit 1994, Seria A nr. 301-B, f.84, par.59, Ostapenko kundër Ukrainës, 14.09.2007, par.51)

142. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se në bazë të vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) Rasti OEN-it, nr.20990/MHM, palët kishin pranuar vendimin e arbitrazhit dhe kanë qenë në dijeni se vendimi i një tribunali të arbitrazhit paraqet vendim final (shih deklaratimet e të autorizuarit të debitorit në seancën e datës 12.04.2024).

143. Rrjedhimisht, që nga koha e nxjerrjes së vendimit të tribunalit të arbitrazhit kreditori kishte një “pritshmëri legjitime” të krijuar nga ky dokument përmbarimor i njohur dhe i ekzekutueshëm në Republikën e Kosovës me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me numër IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019.

144. Andaj kjo gjykatë gjen se pretendimet e debitorit që vendimi i arbitrazhit si dokument përmbarues të ketë klauzolë të përmbarueshmërisë është i pabazë dhe se pikërisht vendimi për njohje dhe ekzekutim të tij, bën që i njëjti të jetë titull përmbarimor i përshtatshëm për përmbarim.

145. Meqenëse aktvendim i Tribunalit të Arbitrazhit sipas të cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarimore, sipas vlerësimit të gjykatës i plotëson kriteret për lejimin e ekzekutimit të tij dhe paraqet dokument përmbarimor/titull ekzekutiv, Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se lidhur me këtë çështje përmbarimore nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

146. Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit sipas ankesës me të cilat debitori pretendon se janë përmbushur detyrime sipas dokumentit përmbarimor, në veçanti pretendimet për njohjen e pagesave dhe atë: (a) Ta njohë pagesën e Telekomit të Kosovës në vlerë 10,443,038.00€ si kompensim për dhënien në shfrytëzim të 90,000 numra shtesë Dardafonit për 70 muaj (nga 06/2017 deri me 12/2023) dhe shfrytëzim shërbimet 3G & 4G për të gjithë Dardafonit (200,000+90,000) për 70 muaj (nga 06/2017 deri me 12/2023), kjo sipas dokumentit “Marrëveshja për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit 20990/MHM”, të nënshkruar nga Kreditori dhe Debitori me dt.24.05.2017, Akt Noterial (“Act en minute”) Nr. LRP 6316/2017 dhe Nr. Ref 1202/2017. (b) Ta zbresë shumën prej 5,887,076.77 € si kamatë e mbingarkuar paligjshëm sepse nuk zbatohet kamata për periudhën deri kur është bërë njohja e vendimit të arbitrazhit nga Gjykata vendore Kosovare; (c) Ta zbresë shumën prej 2,509,731.36 € si kamatë shtesë e ngarkuar paligjshëm, e kërkuar gjatë periudhës në procedurën përmbarimore kur vetë Dardafon.net ka kërkuar përmbarimin e shumave të pasakta dhe Gjykatat i kanë dhënë të drejtë Telekomit.

147. Dhomat e Shkallës së Parë në arsyet e dhëna kanë konstatuar se palët ndërgjyqëse me datën 24.05.2017 sipas nr. të protokollit 01-2124/17 kanë lidhur marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, Sipas të cilës palët janë dakorduar për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit ndërkombëtar nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, duke mundësuar pezullimin e efekteve negative anësore dhe vonesave kohore në operacionet legale, pezullimin e ekzekutimit ndërkombëtar të vendimit të arbitrazhit, vazhdimin e bashkëpunimit komercial në mes të palëve dhe zbatimin e MSA (*Marrëveshjes për mbështetje e lidhur në mes të PTK Sh. A dhe Dardafon.net L.L.C të datës 16 janar 2009*), respektimin pa kurrfarë kufizimi dhe kushtëzimi të marrëveshjes bazë të MSA të datës 16.11.2009, konform interpretimeve obligative nga vendimi final i Arbitrazhit Ndërkombëtar, dhe gjetjen e modaliteteve në bazë të mirëkuptimit të palëve për lehtësimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit duke mënjanuar rrezikun që debitori të bllokohet në operacione nga iniciimi i procedurës së përmbarimit të vendimit të arbitrazhit.

148. Me qëllim të implementimit të kësaj marrëveshje, palët janë dakorduar që kreditori pajtohet të heq dorë nga procedura e iniciuar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, ndërsa debitori të heq dorë nga padia e iniciuar për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Po ashtu të njëjtit janë dakorduar se nëse debitori tërhiqet nga kjo marrëveshje brenda afatit gjashtë mujor i njëjti pranon kthimin në situatën nga vendimi final i arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, ndërsa obligimet eventuale të paguara, nga debitori deri në atë kohë, sipas kësaj marrëveshje, do të kalkuloohen në mënyrën dhe kuptimin e ekzekutimit të dispozitave bazë të vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016.

149. Po ashtu sipas kësaj marrëveshje debitori është pajtuar që në rast të dështimit të përmbushjes së obligimeve të dala nga kjo marrëveshje, kreditori mund ta shkëpus këtë marrëveshje dhe automatikisht të jenë në fuqi dispozitat e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, me ç'rast kreditori do të mund të ri inicioj procedurat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, ose të ekzekutoj procedurat për ekzekutimin e kësaj marrëveshje.

150. Është evident fakti se kreditori me njoftimin për shkëputjen e kontratës me Nr.prot 01 1562/18 të datës 27.04.2018, e ka njoftuar debitorin se shkëput marrëveshjen e lidhur për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016 të datës 24.05.2017 për shkak të mos përmbushjes së saj nga ana e debitorit.

151. Kjo Gjykatë vlerëson se debitori me prapësimin e datës 18.07.2019 (shih pikën 22, fq. 5 të prapësimin) nuk e kishte kundërshtuar shkëputjen e marrëveshjes së vitit 2017 e titulluar si “Marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të dt.09.12.2016, e datës 24.05.2017”. Ndërkaq, gjatë rrjedhës së procesit përmbarimor, përfshirë këtu pretendimet në ankesë dhe deklaratimet në seancën e datës 12.04.2017 pretendon zbatimin për detyrimet nga kjo marrëveshje.

152. Është fakt i pakontestueshëm se pas shkëputjes së marrëveshjes së lartcekur, kreditori ka iniciuar procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit nr.20990/MHM të datës 09.12.2016, i cili vendim sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me numër IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019 është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm.

153. Pas njohjes dhe shpalljes të ekzekutueshëm të vendimit të lartcekur të arbitrazhit sipas Aktvendimit me numër IV.C.nr.388/18 të datës 11.02.2019 nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, kreditori ka iniciuar procedurën përmbartimore në bazë të dokumentit përmbartimor – Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit OEN Nr.20990 / MHM, të datës 9 dhjetor 2016, sipas të cilit Përmbartuesi Privat ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr.491/19 të datës 15.07.2019, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit.

154. Me datën 17.11.2020 kreditori dhe debitori kanë lidhur Marrëveshjen për ekzekutimin e borxhit në procedurën përmbartimore Nr.01-156/09, të datës 17.11.2020, ku në nenin 2 të marrëveshjes kreditori dhe debitori janë dakorduar se: *“1. Borxhi i mbetur i pa paguar dhe pa ekzekutuar nga Vendimi i Arbitrazhit është 17,281,141.98 €; 2. Borxhi i mbetur do të paguhet në procedurën përmbartimore në 24 këste mujore nga ana e debitorit duke filluar nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023. Kësti mujor paguhet me datë 15 deri 20 të secilit muaj. Kësti mujor i kryegjësë është 720,047.58 €; 3. Deri në pagesën e tërësishme të borxhit debitori i detyrohet kreditorit kamatën vjetore prej 7% e cila do të llogaritet dhe paguhet në baza mujore; 4. Shpenzimet e përmbartimit do ti shtohen borxhit të mbetur dhe do të paguhet nga debitori sipas dispozitave të LPP-së; 5. Gjatë periudhës së paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, kreditori nuk do të bllokoj llogaritë e debitorit dhe nuk do të ndërmarr veprime përmbartimore, përveç rasteve të parapara me nenin 4 të kësaj marrëveshje”,* ndërsa në nenin 4 të marrëveshjes është përcaktuar se: *“në rast se debitori nuk i përmbahet detyrimeve nga paragrafi 2 dhe afateve të pagesës, shuma e borxhit të mbetur, kamata dhe shpenzimet tjera të përmbartimit, duke ia zbritur shumat e paguara sipas kësaj marrëveshje do të bëhen të kërkueshme dhe përmbartuesi privat do të vazhdoj menjëherë me veprime përmbartimore ndaj pasurisë së debitorit, duke përfshirë bllokimin e llogarive bankare, inkasimin e mjeteve dhe përmbartimi mbi pasurinë e debitorit dhe veprimet tjera përmbartimore, pa nevojë të ndonjë udhëzimi shtesë nga kreditori ose pa ndonjë lajmërim ndaj debitorit.”*

155. Në procesverbalin e datës 18.12.2020 të përpiluar në zyrën e përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha palët e kanë njoftuar përmbartuesin privat se me datën 16.11.2020 kanë arritur marrëveshje për pagesën e detyrimit të borxhit të përgjithshëm për periudhën prej 24 muajve sipas planit të amortizimit të pagesave, për çfarë përmbartuesi privat ka nxjerrë konkluzionin me të cilin është: *1) aprovuar marrëveshja e arritur ndërmjet palëve për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të specifikuar në procesverbal; 2) është obliguar debitori ti paguaj këstet mujore të borxhit në shumën prej 749,973.60€ sipas planit të amortizimit të pagesave nga data 15.01.2021; 3) është obliguar debitori ti paguaj këstet mujore të shpenzimeve në shumën prej 10,619.63€ për çdo muaj nga data 15 janar 2021 ndërsa në pikën 4) është përcaktuar se në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes nga debitori për pagesën e kësteve të borxhit dhe*

*shpenzimeve sipas dinamikës së pagesave do të veprohet konform kërkesës së kreditorit për përmbushjen e tërësishme të borxhit, kamatëvonesës dhe shpenzimeve.*

156. Me aktvendimin e Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.207/23 të datës 16.02.2024 që është objekt ankimi, në pikën I. të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar propësimi i debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., dhe është lënë në fuqi Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34 € (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent).

157. Duke qenë se kjo Gjykatë gjeti se aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë sa i përket vlerësimit të dokumentit përmbarimor – vendimit të arbitrazhit, nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të LPP dhe me dispozitat e LPK-së, të cilat zbatohen përshtatshëmrisht, vlerëson se debitori detyrohet ndaj kreditorit që t'i paguaj borxhin sipas dokumentit për përmbarim.

158. Në procedurën e zhvilluar sipas ankesës në Dhomat e Shkallës së Dytë, gjykata ka vlerësuar se është e nevojshme nxjerrja e ekspertizës financiare për të përcaktuar pagesat e kryera nga debitori dhe kamatat që implikojnë borxhin nga pagesat e kryera (shih arsyetimin në pjesën IV. 99-120).

159. Duke qenë se gjykata ia ka falur besimin ekspertizës plotësuese të grupit të ekspertëve, të cilët kanë konkluduar se bazuar në detyrimin e përcaktuar në dokumentin përmbarimor – vendimin e Arbitrazhit (OEN) Nr.20990/MHM, datë 09.12.2016, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit, Telekom i Kosovës Sh.A. deri në vendosjen sipas aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.04.2024 të Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është në shumë të përgjithshme prej 5,449,939.83 €, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

160. Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.207/23 të datës 16.02.2024, duhet të ndryshohet vetëm sa i përket shumës së gjykuar në pikën I. të dispozitivit. Kjo për faktin se kjo Gjykatë pas mbajtjes së seancës dëgjimore rreth pretendimeve ankimore dhe nxjerrjes së ekspertizës financiare, respektivisht plotësimit të saj të datës 08.05.2024, erdhi në përfundim se shuma e mbetur e borxhit, bazuar në detyrimin e përcaktuar në dokumentin përmbarimor – Vendimi Përfundimtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr.20990/MHM, datë 09.12.2016, borxhi i mbetur i papaguar i Debitorit, Telekom i Kosovës Sh.A. deri në vendosjen sipas aktvendimit KPPP.nr.2074/23 të datës 16.04.2024 të Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, është në shumë të përgjithshme prej 5,449,939.83 €.

161. Kreditori nuk ka bërë ankesë ndaj aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 dhe nuk janë kërkuar llogaritjet e kamatave përtej vendimit të shkallës së parë, e po ashtu kreditori nuk e ka kundërshtuar ekspertizën plotësuese financiare.

162. Nisur nga fakti se shuma e detyrimit sipas ekspertizës plotësuese rezulton në shumën prej 5,449,939.83 €, për dallim nga shuma e përcaktuar nga Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024 e cila ka gjykuar shumën prej 5,732,871.34 €, Dhoma e Shkallës së Dytë vendosi që të aprovojë pjesërisht ankesën e debitorit dhe është gjykuar si në pikën I të këtij aktvendimi, ku kjo gjykatë ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, ashtu që është ndryshuar pika I. e dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/2023 të datës 16.02.2024, dhe u gjykua si në vijim: Të shfuqizohet pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 282,931.51 € (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë e një cent). Ndërkaq gjykata e la në fuqi Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr 491/19 i datës 15.07.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,449,939.83€ (pesë milion e katërqind e katër dhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e tre cent).

163. Sa i përket gjykimit si në pikën I. të dispozitivit, gjykata vendimin e mbështeti në ekspertizën plotësuese të grupit të ekspertëve, nxjerrja e së cilës ka pasur qëllim që në këtë procedurë përmbarimore të përcaktojë saktë shumën e detyrimit që debitori e kishte bazuar në dokumentin përmbarimor, përfshirë këtu marrëveshjen që palët kishin lidhur mes vete për ekzekutimin e borxhit me datë 16.11.2020, e cila ishte aprovuar si marrëveshje në këtë procedurë përmbarimi para përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha me datë 18.12.2020.

164. Duke qenë se nga ekspertiza plotësuese rrjedh se vlera e mbetur e borxhit është në shumë prej 5,449,939.83€, atëherë gjykata e ka zbritur shumën nga aktvendimi i atakuar KPPP.nr.2074/2023 të datës 16.02.2024 që ishte në vlerë prej 5,732,871.34, nga e cila rezulton se duhet shfuqizuar urdhri për përmbarim për shumën prej 282,931.51 €.

165. Gjykata rithekson se ekspertiza dhe ajo plotësuese kanë pasur qëllim përcaktimin e saktë të shumës së borxhit që debitori i detyrohet kreditorit, duke përfshirë këtu akordimet që ishin bërë me marrëveshje në këtë procedurë. Duhet nënvizuar edhe njëherë se gjykata me konkluzion kishte lejuar llogaritjen e interesit të kalkuluar në shumën prej 1,728,506.93 € duke e llogaritur sipas bazës së saktë që ishte në kohën e lidhjes së marrëveshjes. Këtu duhej përfshirë edhe shuma prej 681,795.04 €.

166. Kjo mënyrë e detyrave të ekspertëve ka pasur qëllim që të vihet deri te vlera e saktë e detyrimit duke i përfshirë pagesat që sipas ekspertëve, palët kishin arritur marrëveshje me një bazë më të lartë të borxhit. Duhet potencuar se lëshimet që të dakordohej marrëveshje me bazë më të lartë të borxhit kanë qenë të vet palës debitore, megjithatë në procedurën përmbarimore pagesat e kryera dhe të paguara për këtë qëllim (pagesat monetare për borxhin objekt përmbarimi), sipas gjykatës do të duhej të merren parasysh. Por, në asnjë mënyrë në procesin përmbarimor nuk mund të eliminohen kamata apo kompensime, qoftë që nuk i takojnë detyrimit monetar, apo të tjera për të cilat gjykata në procedurën e përmbarimit nuk mund të bëjë kompensim detyrimesh.

167. Fillimisht, duhet ripërsëritur se marrëveshja e vitit 2020 e dakorduar në këtë procedurë përmbartimore është e zbatueshme dhe pjesë e kalkulimeve që palët ishin dakorduar me qëllim të zbatimit të detyrimit.

168. Arsyetimet e përfaqësuesve të debitorit se marrëveshja e vitit 2020 ku është bërë llogaritja e shumave të borxheve deri në atë kohë, ishte lidhur nën presion të bllokimit të llogarive nga përmbartuesi privat, për gjykatën nuk paraqet argument të bazuar ligjor.

169. Së pari, bllokimi i llogarive bankare nga organi përmbartues paraqet mjet përmbartimi të parashikuar me LPP. Ky mjet përmbartimi ka qenë me efekt për shkak të mos pagesës vullnetare të borxhit nga ana e debitorit që detyrohej me dokument përmbartimor. Sipas Gjykatës, nuk mund të pretendohet se veprimi i përmbartuesit ka qenë juridikisht i pambështetur. Sepse debitori, hyrjen në një marrëveshje juridikisht të detyrueshme nuk mund ta kontestojë me deklaratë të thjeshtë në procedurë, pasi që ka vlerësuar se llogaritja e borxhit ka qenë e dëmshme. Por, që një marrëveshje të shpallet juridikisht e pavlefshme duhet ndjekur procedura të ligjshme gjyqësore, e të cilat debitori nuk ka arritur t'i provojë në këtë gjykatë.

170. Gjykata nuk mund ta anashkalojë apo në çfarëdo mënyre ta zhbëjë marrëveshjen e vitit 2020 për ekzekutimin e borxhit, vetëm se debitori si person juridik tani thirret me pretendim ankimor në shtrëngim apo presion të bllokimit të llogarive. Veprimet e tilla të ndërmarra nga palët, përfshirë këtu subjektet juridike, janë veprime juridikisht detyruese dhe të përgjegjshme në raport me palët tjera në procedurë të përmbartimit.

171. Andaj, edhe nëse debitori pretendon se lidhja e marrëveshjes së vitit ka qenë e dëmshme për të si palë apo e njëjta nuk ka fuqi juridike për çfarëdo arsye, është në përgjegjësinë e debitorit lidhja e së njëjtës dhe gjykata nuk mund të anulojë një marrëveshje juridikisht të ligjshme në një procedurë përmbartimi. Çdo devijim nga marrëveshjet e dakorduara mes palëve përfshirë këtu ato në procedurën e përmbartimit, do të ishte ndërhyrje në parimin e vullnetit të lirisë së kontraktimit të palëve.

172. Ndonëse lidhur me pretendimet ankimore për mos-zbatim të marrëveshjes së vitit 2020 mes palëve, janë dhënë arsye në pikën 100-107 të Kreut IV të arsyetimit, gjykata e sheh të nevojshme të ri-përsëritë se asgjë në këtë procedurë dhe asnjë veprim nuk mund të jetë faktor që gjykata ex-officio apo në çfarëdo mënyre të anashkalojë, anulojë apo në çfarëdo mënyre ta zhbëjë një akt juridikisht të ligjshëm që palët me vullnetin e tyre e kanë lidhur në procedurë para organit përmbartues.

173. Pretendimet e vazhdueshme të debitorit se marrëveshja e vitit 18.12.2020 e lidhur tek përmbartuesi privat Ilir Mulhaxha, ka qenë e lidhur nën presion, për shkak se debitori i ka pasur llogaritë e bllokuara, është arsye e thjeshtë deklarative që nuk e anulon marrëveshjen.

174. Gjykata rikujton se një marrëveshje e ligjshme e lidhur në procedurë para organit përmbartues, mund të quhet nule vetëm nëse e njëjta është anuluar në procedurë të rregullt

gjyqësore dhe jo thjeshtë me pretendim të palës. Kjo mënyrë e veprimit do të shkelte barazinë e palëve dhe sigurinë juridike në raportet kontraktore.

175. Andaj, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se nuk janë të bazuara pretendimet e debitorit se ka qenë i detyruar ta lidhë marrëveshjen Nr.01-156/09, të datës 17.11.2020, për pagesën e borxhit që rezulton nga vendimi i arbitrazhit, pasi që një pretendim i tillë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në këtë procedurë, meqenëse debitori ka mundur që brenda afateve ligjore në procedurë gjyqësore të rregullt ta kontestoj këtë marrëveshje, por meqenëse kjo marrëveshje me asnjë vendim gjyqësor nuk është anuluar, shërben si bazë valide, mbi të cilën krijohet detyrimi në procedurën përbarimore dhe e njëjta nuk mund të kontestohet në këtë procedurë.

176. Në procedurën e përbarimit sipas prapësimit, gjykata shqyrton vetëm ligjshmërinë në aspektin formal të dokumentit përbarimor. Këtu gjykata ka vendosur të caktojë ekspertizë vetëm me qëllim që palës t'i jepet mundësia e evidentimit të borxhit të saktë, duke eliminuar kamatat që rrjedhin nga pagesat që veçse ishin kryer nga debitori, e që në realitet për to debitori kishte lidhur një marrëveshje me bazë më të lartë të borxhit sesa kishte në realitet.

177. Pra, gjykata me ekspertizë ka lejuar të njihen pagesat e kryera nga debitori në këtë procedurë të përbarimit, e që debitori përkundër kësaj kishte lidhur marrëveshje të vitit 2020 me bazë më të lartë të borxhit sesa kishte pasur në kohën e lidhjes së marrëveshjes. Një gjë e tillë arsyetohet me faktin se në një proces gjyqësor duhet të njihen pagesat e kryera monetare për atë qëllim, siç janë në rastin konkret pagesat të cilat janë elaboruar në pikën 117 të arsyetimit, të cilat debitori i kishte kryer gjatë rrjedhës së përbarimit në faza të ndryshme

178. Megjithatë, kategoritë tjera që debitori synon t'i zbres nga borxhi nuk janë pretendime të mbështetura në Ligj, sepse siç është arsyetuar në pikën IV.4.1 të arsyetimit, gjykata nuk mund të eliminojë detyrimet e kamatave varësisht nga pritjet e palëve, por ato duhet llogaritur bazuar në detyrimet sipas dokumentit përbarimor, duke mos anashkaluar konkludimet reciproke të palëve me marrëveshjen e vitit 2020 të aprovuar me konkluzion para përbaruesit privat me datë 18.12.2020.

179. Gjykata rithekson se palët i kanë përcaktuar vet me vullnetin e tyre periudhat e llogaritjes së kamatave me marrëveshjen e vitit 2020, në të cilën të dyja palët kanë deponuar tabelat e llogaritjes së borxhit përfshirë kamatat. Andaj, gjykata nuk mund të eliminojë kamatat e kontraktuara dhe dakorduara nga palët me marrëveshje në procedurën e përbarimit.

180. Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me kërkesën që të llogariten si kompensim fitimi që kreditori kishte nga 90,000 numrat dhe shërbimet 3G dhe 4G sipas pikës 6, a) të ankesës, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

181. Ndonëse janë dhënë arsye të detajuara për këto pretendime në pikat (71-85 të arsyetimit) gjykata e sheh të nevojshme të ri përsëritë se kompensimi që debitori pretendon të zbatohet në borxhin kryesor, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në këtë procedurë. Së pari, detyrimi për

dhënien e numrave është detyrim që rrjedh nga vendimi i arbitrazhit pika V, 1 a) dhe b). Për këtë palët kishin lidhur marrëveshje në vitin 2017, shkëputjen e së cilës nuk e kishte kontestuar debitori. Për më tepër, me lidhjen e marrëveshjes në procedurën e përmbarimit të vitit 2020, palët nuk kanë paraparë llogaritjen e kompensimeve të tilla. Rrjedhimisht, Gjykata nuk ka tagër dhe as mundësi ligjore që në një procedurë përmbarimore të zbresë borxhin kryesor të njëres palë nga fitimet e palës tjetër që ka realizuar prej detyrimeve në natyrë që rrjedhin nga po i njëjti vendim i arbitrazhit (pikat 80-85 të arsytimit).

182. Pretendimet tjera në ankesë nga pika 6 b) dhe c), fq. 2 të elaboruara nga debitori edhe në seancën e datës 12.04.2022, si dhe në parashtrësën e debitorit për korrigjim të ekspertizës (dt.31.05.2024) – sa i përket zbritjes së shumave 5,887,076.77€ dhe 2,509,731.36 si kamatë e ngarkuar paligjshëm, gjykata nuk i mori si pretendime të bazuara në ligj.

183. Gjykata vë në pah faktin se palët me datë e datën 17.11.2020 kanë lidhur Marrëveshjen për ekzekutimin e borxhit në procedurën përmbarimore Nr.01-156/09, të datës 17.11.2020. Në Nenin 2 të kësaj marrëveshje palët ndër të tjera janë dakorduar se: *“3.Deri në pagesën e tërësishme të borxhit debitori i detyrohet kreditorit kamatën vjetore prej 7% e cila do të llogaritet dhe paguhet në baza mujore; 4. Shpenzimet e përmbarimit do ti shtohen borxhit të mbetur dhe do të paguhen nga debitori sipas dispozitave të LPP-së; 5. Gjatë periudhës së paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, kreditori nuk do të bllokoj llogaritë e debitorit dhe nuk do të ndërmarr veprime përmbarimore, përveç rasteve të parapara me nenin 4 të kësaj marrëveshje”,* ndërsa në nenin 4 të marrëveshjes është përcaktuar se: *“në rast se debitori nuk i përmbahet detyrimeve nga paragrafi 2 dhe afateve të pagesës, shuma e borxhit të mbetur, kamata dhe shpenzimet tjera të përmbarimit, duke ia zbritur shumat e paguara sipas kësaj marrëveshje do të bëhen të kërkueshme dhe përmbaruesi privat do të vazhdoj menjëherë me veprime përmbarimore ndaj pasurisë së debitorit, duke përfshirë bllokimin e llogarive bankare, inkasimin e mjeteve dhe përmbarimi mbi pasurinë e debitorit dhe veprimet tjera përmbarimore, pa nevojë të ndonjë udhëzimi shtesë nga kreditori ose pa ndonjë lajmërim ndaj debitorit.”*

184. Në procesverbalin e datës 18.12.2020 të përpiluar në zyrën e përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha palët e kanë njoftuar përmbaruesin privat se me datën 16.11.2020 kanë arritur marrëveshje për pagesën e detyrimit të borxhit të përgjithshëm për periudhën prej 24 muajve sipas planit të amortizimit të pagesave, për çfarë përmbaruesi privat ka nxjerrë konkluzionin me të cilin është: *1) aprovuar marrëveshja e arritur ndërmjet palëve për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të specifikuar në procesverbal; 2) është obliguar debitori ti paguaj këstet mujore të borxhit në shumën prej 749,973.60€ sipas planit të amortizimit të pagesave nga data 15.01.2021; 3) është obliguar debitori ti paguaj këstet mujore të shpenzimeve në shumën prej 10,619.63€ për çdo muaj nga data 15 janar 2021 ndërsa në pikën 4) është përcaktuar se në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes nga debitori për pagesën e kësteve të borxhit dhe shpenzimeve sipas dinamikës së pagesave do të veprohet konform kërkesës së kreditorit për përmbushjen e tërësishme të borxhit, kamatëvonesës dhe shpenzimeve.*

185. Gjykata sqaron se palët me marrëveshje kanë përcaktuar dhe kanë llogaritur të gjitha kamatat sipas marrëveshjes së tyre të lirë. Po ashtu, edhe me dispozitat e Nenit 378 par.1, 383



dhe 384 të LMD-së janë rregulluar aspektet ligjore të kamatave të cilat zbatohen në rastin konkret, deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit.

186. Duhet ritheksuar se pretendimi i debitorit se kamatat e arritura në shumën prej 5,887,076€ dhe 2,509,731.36€ (për periudhën deri në njohjen e vendimit të arbitrazhit dhe gjatë periudhës në procedurën përmbimore), janë të paligjshme, nuk qëndron. Kjo për faktin se kamata është kërkesë aksesore e cila rrjedhë deri në përmbushjen vullnetare apo përmbushjen e plotë të detyrimit – gjë që debitori nuk e kishte përmbushur në gjykimin në shkallë të parë. Pretendimet e debitorit se kamata deri në njohjen e vendimit të arbitrazhit është e jashtëligjshme nuk gjen mbështetje as ligjore dhe as faktike. Pra, nuk ekziston asnjë praktikë gjyqësore ku kamata ndërpritet në fazë të caktuara të procedurës gjyqësore. Ngjashëm me këtë edhe pretendimi për kamatën gjatë periudhës nga data e njohjes së vendimit të huaj deri në llogaritjen nga debitori (shih pretendimin në seancën e dt.12.04.2024), është i paqëndrueshëm ngase rrjedhën e kamatës nuk e ndalon inicimi apo çfarëdo faze në procedurën përmbimore.

187. Duhet ritheksuar se palët për kamatat janë dakorduar me marrëveshje, ndërkaq debitori nuk e ka përmbushur detyrimin në mënyrë vullnetare. Sa i takon pretendimit të debitorit me ankesë se konform Nenit 245 është përmbushur detyrimi, në veçanti me dhënien e 90,000 numrave dhe shërbimeve 3g dhe 4g, pretendimi i tillë nuk qëndron. Së pari, përmbushja e këtij detyrimi në dhënie ka qenë detyrim që rrjedhë nga pika VI, 1 a) dhe b) e vendimit të arbitrazhit. Së dyti, këto shërbime ishin dhënë si rezultat i marrëveshjes së vitit 2017, shkëputjen e së cilës debitori nuk e ka atakuar. Andaj, lidhur me këto pretendime, ankesa është refuzuar si e pabazuar.

## 5.2. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të debitorit në pikën II, III dhe IV të aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024

188. Sa i përket pretendimeve të debitorit të paraqitura lidhur me ankesën për parregullsi të datës 14.11.2022, ndaj pikës II të aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar në këtë pikë është i pabazuar.

189. Lidhur me pretendimet e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se përmbaruesi privat pas pranimit të Aktvendimit KPPP.nr 1996/22 të datës 27.10.2022, ka caktuar ekspertizën financiare me qëllim të kalkulimit të obligimit të mbetur sipas aktvendimit të Gjykatës dhe me datë 01.11.2022. Përmbaruesi privat përmes komunikimit elektronik i është drejtuar debitorit duke e njoftuar të njëjtin se ka caktuar ekspertizën financiare dhe pas kalkulimit të bërë nga eksperti financiar ka rezultuar se obligimi total i mbetur i debitorit është në shumën prej 5,980,491.66 €, ndërsa shpenzimet e procedurës përmbimore arrijnë shumën prej 85,935.85 € dhe ka kërkuar nga debitori që pagesa e shumës prej 6,066,427.51 €, të përmbushet në mënyrë vullnetare deri me datën 01.11.2022.

190. Është evident fakti se pas paraqitjes së kundërshtimeve të debitorit në lidhje me ekspertizën financiare, përmbaruesi privat ka mbajtur dy seanca dhe atë me datën 23.12.2022 dhe me datën 10.01.2023, ku pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit, ka nxjerr konkluzion

me të cilin ka aprovuar propozimin e debitorit që pika 2 dhe 5 të plotësohen në ekspertizë sipas gjetjeve të konstatuara në seancë, kurse për pikën 4 eksperti të sqaroj në plotësim të ekspertizës. Nga plotësimi i ekspertizës financiare për pikën 2 dhe 5, rezulton se kamata e paguar sipas planit të pagesave është zbritur në shumën prej 100,439.55 €.

191. Sipas Dhomave të Shkallës së Dytë qëndron konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se pretendimet e debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsitë e kryera nga përmbartuesi privat, nuk janë të drejtuara drejt veprimeve të ndërmarra nga i njëjti por më tepër konstatime të dhëna për mënyrën e pranimit të vendimit të gjykatës dhe veprimit në përputhje me atë vendim.

192. Kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të debitorit janë të paqëndrueshme sepse gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstaton se përmbartuesi privat ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, ashtu që pas pranimit të aktvendimit KPPP.nr 1996/22 të datës 27.10.2022, ka caktuar ekspertizën financiare me qëllim të kalkulimit të obligimit të mbetur.

193. Pretendimi i debitorit për mënyrën e dorëzimit të aktvendimit KPPP.nr 1996/22 të datës 27.10.2022, nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe as faktike, sepse përmbartuesi privat vendimin e atakuar ia ka dorëzuar palëve nga Gjykata përmes shërbimit postar dhe se në rastin konkret nuk ka ndonjë veprim të përmbartuesit i cili do të mund të trajtohej si parregullsi formale në procedurë, e cila do të ishte arsye apo përbën parregullsi eventuale.

194. Lidhur me pretendimin e debitorit se përmbartuesi privat ka kryer parregullsi sa i përket llogaritjes së lartësisë së kamatës nga eksperti financiar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka ardhur në përfundim se përmbartuesi privat nuk ka kryer parregullsi, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se pas përpilimit të ekspertizës financiare, debitorit ka paraqitur kundërshtimet e tij e për të cilat kundërshtime përmbartuesi privat ka mbajtur dy seanca dhe atë me datë 23.12.2022 dhe me datë 10.01.2023, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit ka nxjerr konkluzion me të cilin ka aprovuar propozimin e debitorit që pika 2 dhe 5 të plotësohen në ekspertizë sipas gjetjeve të konstatuara në seancë, kurse për pikën 4 eksperti të sqaroj në plotësim të ekspertizës. Gjykata e shkallës së parë po ashtu, ka vlerësuar se eksperti financiar duke vepruar sipas konkluzionit të përmbartuesit privat të nxjerrë në seancën e datës 10.01.2023, ka bërë plotësimin e ekspertizës financiare në pikën 2 dhe 5, nga ku ka rezultuar se është zbritur kamata e paguar sipas planit të pagesave në shumën prej 100,439.55 €.

195. Andaj, Dhomat e Shkallës së Dytë vien në përfundim se organi përmbartues/përmbartuesi privat nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përmbartimor në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe se aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, në pikën II të dispozitivit është i bazuar.

196. Sa i përket pretendimeve ankimore të debitorit që i referohet pikës III dhe IV të aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se:

197. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në rastin kur e ka hedhur si të palejuar kërkesën e debitorit me të cilën ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe pezullimin e procedurës përmbare P.nr.491/19 të datës 15.07.2019 si dhe kërkesën që të detyrohet kreditori që deri në përfundim e procedurës gjyqësore përmbare të deponojë në llogarinë e gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv në vlerë prej 13,116,165.73 €.

198. Sipas kësaj Gjykate, qëndrojnë arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar se në procedurën përmbare është përcaktuar e drejta e paraqitjes së mjetit juridik përkatësisht prapësimi ndaj urdhrin përmbare si dhe kërkesa për shtyrjen apo pezullimin e procedurës përmbare, mirëpo me asnjë dispozitë ligjore të LPP-së, nuk është përcaktuar e drejta e paraqitjes së masave të sigurimit në procedurë përmbare dhe si rrjedhojë për kërkesat e tilla, gjykata nuk mund të ofroj mbrojtje juridike në këtë procedurë.

199. Në këtë drejtim, me dispozitën e Nenit 65 të LPP-së, përcaktohet se *“Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përmbaremi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana: 1.1. kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbaremit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organin përmbareues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë; 1.2. kur është tentuar nga organi përmbareues që të zbatohet përmbaremi i vendimit të paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime; 1.3. kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbaremi vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbareues saktësinë e adresës”*.

200. Është i bazuar konstatimi i Dhomave të Shkallës së Parë se në rastin konkret rezulton se debitori kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit nuk e ka mbështetur në asnjërin nga shkaqet e përcaktuara sipas të cilave mund të pezullohet procedura përmbare, mirëpo pretendimet e paraqitura nga ana e debitorit përbëjnë pretendime për caktimin e masave të sigurimit në një procedurë kontestimore e të cilat nuk mund të trajtohen në procedurën përmbare për shkak të parimit të formalitetit rigoroz.

201. Ngjashëm me këtë, edhe Dhomat e Shkallës së Dytë e kanë hedhur poshtë si të palejuar propozimin për pezullimin e procedurës (shih pikën 44-48 të arsytimit) të parashtruar nga debitori në seancën e datës 12.04.2024.

202. Ndërsa sa i përket kërkesës së debitorit për caktimin e masës së sigurimit, Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë ankimore, vlerësojnë se kërkesa e debitorit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet kreditori që deri në përfundimin e procedurës gjyqësore përmbare, të deponojë në llogarinë e gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv në vlerën prej 13,116,165.73 €, - përbën kërkesë të palejuar në këtë procedurë.

203. Kjo gjykatë e mbështet qëndrimin e Dhomave të Shkallës së Parë se në rastin konkret debitori kërkon realizimin e kërkesës përmes masës së sigurisë, ndërsa sipas LPK-së, masa e

sigurisë caktohet për mbajtjen e gjendjes aktuale dhe parandalimin e ndryshimit të gjendjes, e cila do të mund të rezultonte me përkeqësim të situatës së propozuesit. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë konstaton se masa e sigurisë nuk mundet në asnjë mënyrë të konsistojnë në veprim apo ndryshim të gjendjes ekzistuese ashtu siç ka kërkuar debitori, e aq më pak në realizim të kërkesës përmes masës së sigurisë, në një procedurë të inicuar sipas kërkesës së kreditorit.

204. Duhet të theksohet se Ligji për Procedurën Përmbartimore (Ligji Nr. 04/L-139) në Kruen VII, ka paraparë shtyrjen, pezullimin dhe përfundimin e përmbartimit. Sipas nenit 61 parashihet shtyrja e përmbartimit sipas kërkesës së debitorit, në rastet kur debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm.

205. Gjykata e shkallës së parë drejtë konstaton se në këto raste dorëzimi i kërkesës për shtyrje të përmbartimit nuk shtyn zbatimin e përmbartimit, ndërsa para lejimit të shtyrjes së përmbartimit, organi përmbartues do t'i sigurojë kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes. Organi përmbartues mundet plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbartimin në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbartimi do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumë e kërkesës. Ndërsa në rrethana të tjera organi përmbartues mundet të kushtëzojë shtyrjen pasi që debitorit të jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumë e kërkesës dhe kamatës.

206. Nga të lartcekurat gjykata vie në përfundim se aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 16.02.2024, nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës në pikën II, III dhe IV të dispozitivit, andaj ankesa e debitorit për këto pika të dispozitivit u refuzua si e pabazuar.

5.3. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura me ankesën e datës 19.03.2024, kundër aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024

207. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2074/23 të datës 15.03.2024 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën për parregullsi të Debitorit “TELEKOMI I KOSOVËS”, Sh.A., e datës 08.03.2024, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet përmbartuesi privat Irfan I. Kërçagu që sipas Aktvendimit KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024 të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, të vazhdoj përmbartimin sipas marrëveshjes Nr.01-156/09 të datës 17.11.2020, për pagesën e borxhit me këste mujore; të detyrohet përmbartuesi privat që të bëj njoftimin e menjëhershëm të të gjitha Bankave Komerciale në Republikën e Kosovës që pas realizimit të tërheqjes së mjeteve nga kësti i 15-të, të liroj menjëherë llogaritë bankare dhe bllokimi i radhës eventual të realizohet nga data 15 deri me datën 20 të secilit muaj pasues sipas kushteve nga Marrëveshja nr.01-156/09, e datës 17.11.2020 deri në një vendosje ndryshe nga ndonjë vendim gjyqësor; të detyrohet përmbartuesi privat që të përmirësoj urdhrin përmbartimor ashtu që të precizoj shumë e përmbartimit sipas Aktvendimit

KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024, në vlerën prej 5,732,871.34 € / 10 këste dhe ta përpjesëtoj të njëjtën me 10 këste për secilin këst mujor; të detyrohet përmbaruesi privat që për të gjitha shpenzimet e efikasitetit për secilin këst të veçantë, ti përcjellë me faturë të veçantë pas secilit inkasim veç e veç si dhe të obligohet përmbaruesi që në rast të tërheqjes më të lartë se të një kësti mujor deri në vendosjen sipas kësaj parashtrëse, çdo diferencë e shumës së tillë ta zbattoj e llogaritë si pagesë të këstit pasues të radhës.

208. Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë debitori Telekom i Kosovës me datë 19.03.2020 dhe ka kërkuar nga Dhomat e Shkallës së Dytë aprovimin e ankesës (shih pika 34 e arsytimit)

209. Dhomat e Shkallës së Dytë pas shqyrtimit të aktvendimit të atakuar, pretendimeve ankimore të debitorit dhe shkresave të lëndës, erdhën në përfundim se ankesa e debitorit për parregullsi kundër përmbarimit është e pabazuar.

210. Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë, aktvendimi i atakuar është i bazuar në ligj dhe nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës. Kjo për faktin se përmbaruesi privat nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përmbarimor qoftë të parregullt apo në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për faktin se përmbarimi është kryer në përputhje me Aktvendimin KPPP.nr 2074/23 të datës 16.02.2024 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, i cili në rastin e përmbarimit të dokumenteve përmbarimore është i ekzekutueshëm në momentin e vendosjes lidhur me ekzekutimin. Pra këtu nuk bëhet fjalë për dokument të besueshëm, rast ky kur për ekzekutimin duhet të pritet procedura ankimore.

211. Në rastin konkret, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar me shkelje procedurale kur ka vlerësuar se përmbaruesi privat gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore, nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Kjo ngase përmbaruesi urdhrin për bllokimin e llogarive të debitorit e ka lëshuar duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës, me të cilin është refuzuar propësimi i debitorit dhe ka mbetur në fuqi urdhri për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,732,871.34 € - vendim ky i gjykatës të cilin përmbaruesi ka pasur për detyrë ta ekzekutoj.

212. Njëherit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar drejtë se sa i përket urdhrin për bllokimin e shumës në vlerën prej 81,324.95 €, gjykata nuk gjeti parregullsi të kryera nga ana e përmbaruesit privat, meqenëse sipas nenit 352 par.1 të LPP-së, parashihet që Përmbaruesi privat ka të drejtë për shpërblim të punës së tij apo kompensim të shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me punën e tij në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbarues privat.

213. Së këndejmi, nuk janë të bazuara as pretendimet ankimore lidhur me bllokimin e llogarive të debitorit edhe për shumën në vlerën prej 81,324.95 €, pasi që gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kjo shumë ka të bëjë me shpenzimet e procedurës përmbarimore, për të cilat përmbaruesi Privat ka të drejtë në shpërblim për punën dhe kompensimin e shpenzimeve nga

fushëveprimi i tij. Në rastin konkret pretendimi i debitorit në ankesën për parregullsi, se shuma e përcaktuar në urdhrin për bllokimin e llogarive tejkalon vlerën e përcaktuar të detyrimit sipas aktvendimit të gjykatës, është i pabazuar meqenëse shuma e lartcekur ka të bëjë me shpenzimet e krijuara gjatë kësaj procedure përmbarimore. Për më tepër debitori në ankesën e tij për parregullsi nuk e konteston edhe detyrimin e tij për të paguar shpenzimet e efikasitetit, mirëpo të njëjtat kërkon që ti paguaj për secilin këst të veçantë.

214. Gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitat e Neni 342 të LPP-së, me të cilën parashihet mbrojtja e të drejtave të debitorit, ka ardhur në përfundim të drejtë dhe të ligjshëm se debitori nuk i pamundësohet e drejta për të paraqitur përsëri ankesë për evitimin e parregullsive, në rastin kur pas përfundimit të veprimeve përmbarimore të përmbaruesit privat dhe pranimit të pasqyrës së shpenzimeve të përmbarimit (e cila i dorëzohet debitorit nga përmbaruesi privat), mund të rezultojë se lartësia për shpenzimet dhe efikasitetin e procedurës përmbarimore lidhur me këtë çështje përmbarimore ka qenë përtej shumave të përcaktuara me tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbaruesit privat.

215. Andaj, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se përmbaruesi privat është i obliguar që të zbatoj vendimin gjyqësor dhe të merr veprime ligjore për ekzekutimin e kërkesës sipas lartësisë së vlerës të përcaktuar në dispozitivin e aktvendimit dhe në asnjë rast përmbaruesit privat nuk i lejohet ndërmarrja e veprimeve në shpërputhje me urdhrin e gjykatës të përcaktuar në dispozitivin e aktvendimit. Deri në këtë fazë ankimore aktvendimi i atakuar ka qenë bazë që përmbaruesi të ndërmerr veprime përmbarimore për ekzekutimin e të njëjtit.

216. Gjykata e shkallës së parë drejt ka konstatuar se marrëveshja e vitit 2020 ka shërbyer si bazë valide për përcaktimin e detyrimit dhe kjo për faktin që debitori pavarësisht pretendimeve se ka qenë i detyruar ta lidhë marrëveshjen Nr.01-156/09, të datës 17.11.2020, në asnjë fazë të kësaj procedure përmbarimore nuk ka arritur që të dëshmoj se kjo marrëveshje është kontestuar në procedurë gjyqësore të rregullt dhe meqenëse e njëjta marrëveshje me asnjë vendim gjyqësor nuk është anuluar.

217. Duhet theksuar se debitori, në njëërën anë marrëveshjen për ekzekutim të borxhit me datën 17.11.2020 me nr. protokollit 01-156/09, e realizuar nga palët tek përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha. Debitori në ankesë dhe gjatë seancave në këtë procedurë përmbarimi e konteston. Ndërkaq, në anën tjetër, debitori në ankesën për parregullsi të datës 08.03.2024, ndër të tjera në petitum të saj kërkon që “ ... bllokimi i radhës eventual të realizohet nga data 15 deri me datën 20 të secilit muaj pasues sipas kushteve nga Marrëveshja nr.01-156/09, e datës 17.11.2020 deri në një vendosje ndryshe nga ndonjë vendim gjyqësor”.

218. Nga të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se ankesa e debitorit për parregullsi ndaj përmbaruesit Privat Irfan Kërcagu është e pabazuar edhe e njëjta u refuzua si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.712/24, me datë 07.06.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova